

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6006
E premte, 21 shkurt 2020
çmimi 0.40 €

Shteti i Xhamajkës në pavarësinë e Kosovës

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AMBASADORI AMERIKAN NË PRISHTINË, PHILIP KOSNETT, NË TAKIMET QË KA PASUR ME LIDERËT INSTITUCIONALË TË KOSOVËS, KA KËRKUAR HEQJEN E TAKSËS 100 PËR QIND NDAJ PRODUKTEVE TË SERBISË DHE BOSNJË E HERCEGOVINËS

SHBA-ja INSISTON PËR HEQJEN E TAKSËS



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë, Philip Kosnett, edhe një herë në takime të drejtpërdrejta u ka kërkuar liderëve shtetërorë heqjen e taksës

100 për qind për mallrat serbe. Në këto takime ai u ka treguar atyre për përfitimet që i ka Kosova nga heqja e taksës. Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar zëvendësimin e saj me

parim të reciprocitetit. Ndërsa njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë thirrje për unitet nacional për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi

Ministrja Haxhiu anulon provimin për noterë



Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e ka kthyer në pikën zero procesin e emërimit të 79 noterëve për 35 komuna të Kosovës, i cili ka ndodhur në prill të vitit të kaluar. Ajo në një konferencë për media ka thënë të enjten se ky proces nuk

ishte ligjor, transparent dhe objektiv. Po ashtu, ministrja Haxhiu ka njoftuar se ka anuluar edhe vendimin për emërimin e Komisionit për Përzgjedhjen e Noterëve si dhe të anëtarëve të Komisionit të Provimit të Noterisë. Ish-ministri i Drejtësisë,

Abelard Tahiri, e ka quajtur veprimin e ministres Haxhiu arbitrar dhe i cili, sipas tij, do të prodhojë pasoja juridike dhe administrative sepse paraqet shkelje flagrante të të drejtave të fituara nga qytetarët e Kosovës



Varrosen pesë anëtarët e familjes Bllaca, sot ditë zie në Gjilan

FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

AKTUALE

GRENELLI EMËROHET DREJTOR I INTELIGJENCËS KOMBËTARE TË SHBA-së F. 2

LDK-JA BËN PUBLIKE EMRAT E PESË ZËVENDËSMINISTRAVE F. 6

KOZ-JA CERTIFIKON KANDIDATËT PËR KRYETAR TË PODUJEVËS F. 3

INSTITUCIONEVE PARASHKOLLORE PA LICENCË U NDALOHET PUNA F. 5



SHKARKOEN 14 KONSUJ NËPËR AMBASADA F. 3

EKONOMI



KURTI: DO TË PUNOJMË FORT QË T'IA KTHEJMË NAMIN GJIGANTIT "TREPÇA" F. 8

ENDRIT SHALA DO TA DREJTOJË KOMISIONIN PARLAMENTAR PËR EKONOMI F. 8

SPORT

KOSOVA TRIUMFON NDAJ ISLANDËS F. 20

Shteti i Xhamajkës njeh pavarësinë e Kosovës

PRISHTINË, 20 SHKURT - Presidenti i vendit Hashim Thaçi, përmes një shkrimi në llogarinë e vet në "Twitter", ka bërë me dije se shteti i Xhamajkës ka njohur pavarësinë e Kosovës.

Thaçi tha se njohja nga

Xhamajka ka ardhur pas lobimit shumëvjeçar dhe ndihmës së kongresistit amerikan, Eliot Engel.

"Lajm i mirë. Sapo u njoftova nga ambasadorja jonë në ShBA, Vlora Çitaku se Xhamajka ka njohur Kosovën

si shtet të pavarur dhe sovran. E di se kjo është rezultat i punës së madhe dhe lobimit për vite të tëra, përfshirë edhe ndihmës së kongresistit Eliot Engel. Faleminderit miqve tanë nga Kingston", ka shkruar Thaçi.



Richard Grenell emërohet drejtor i Inteligjencës Kombëtare të ShBA-së

Presidenti amerikan ka njoftuar se ambasadori i ShBA-së në Gjermani, Richard Grenell, do të bëhet drejtor në detyrë i Zbulimit Kombëtar, por se ai do të vazhdojë të mbajë edhe postin e ambasadorit në Gjermani dhe i dërguari i Trumpit për bisedimet Kosovë-Serbi



WASHINGTON, 20 SHKURT - Presidenti Donald Trump konfirmoi se po emëron ambasadorin amerikan në Gjermani Richard Grenell si drejtor në detyrë të Zbulimit Kombëtar.

Një zyrtar i Shtëpisë së Bardhë i tha "Zërit të Amerikës" se ai do të vazhdojë të mbajë edhe postin e ambasadorit në Gjermani. Richard Grenell është i dërguar i presidentit Trump për bisedimet Kosovë-Serbi.

Presidenti e bëri njoftimin të mërkurën vonë në Twitter, pak orë pasi lajmi u bë i ditur nga disa media amerikane.

"Jam i kënaqur të njoftoj se ambasadori ynë shumë i

respektuar në Gjermani, Richard Grenell, do të bëhet drejtor në detyrë i Zbulimit Kombëtar. Rick (Richard Grenell) ka përfaqësuar vendin tonë jashtëzakonisht mirë dhe mezi pres të punoj me të", shkruante presidenti Trump në Twitter.

Drejtori i Zbulimit Kombëtar mbikëqyr gjithë komunitetin e inteligjencës amerikane të përbërë nga 16 agjenci dhe bashkëpunon ngushtë me drejtorin e Departamentit të Sigurisë Kombëtare.

Meqenëse do të jetë drejtor në detyrë i Zbulimit Kombëtar, Grenelli nuk ka nevojë për konfirmim nga Senati.

Grenelli tha se nuk do të jetë ai që do të emërohet nga presidenti Trump si drejtor i përhershëm në këtë post. Presidenti, tha Grenelli në Twitter, do ta bëjë njoftimin për drejtorin e përhershëm së shpejti, por nuk do të emërojë atë në këtë post.

Richard Grenell ka qenë zëdhënës i ShBA-së në Kombet e Bashkuara në kohën e presidentit George W.

Bush. Para kësaj ka qenë komentator në shtyp dhe televizion si dhe themelues i një firme për marrëdhënie me publikun.

Ai nuk ka përvojë të drejtpërdrejtë në komunitetin e inteligjencës, por shihet si mbështetës i besnik i presidentit Trump dhe politikave të tij.

Grenelli ka folur sidomos hapur

në lidhje me ato që ai i quan rreziqe që paraqet biznesi me gjigantin kinez të telekomunikimit Huawei. Ai i ka bërë thirrje Gjermanisë të mos bëhet klient i Huawei për shkak të dyshimeve se kompania instalon në produktet e saj pajisje përgjimi me kërkesë të Pekinit.

Grenelli do të jetë anëtar i parë 'gay' i kabinetit në historinë e ShBA-së.

Ai do të zëvendësojë shefin e tanishëm në detyrë të Zbulimit kombëtar Joseph Macguire i cili pasoi drejtorin e mëparshëm Dan Coats që u shkarkua korrikun e kaluar nga presidenti.

Presidenti Trump ka pasur një marrëdhënie të tensionuar me komunitetin e tij të inteligjencës pasi ky arriti në përfundimin se Rusia kishte ndërhyrë në zgjedhjet presidenciale të 2016-s dhe paralajmëroi në lidhje me kërcënimin që përbën ngrohja globale për sigurinë kombëtare.

Presidenti Thaçi pranoi kredencialet e ambasadorit jorezident të Guineas për Kosovën

PRISHTINË, 20 SHKURT (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pranuar të enjten kredencialet e Ambasadorit të Republikës së Guineas, Diallo Mamadou Siradiou, ambasador jorezident për Kosovë.

Duke e uruar për punën e re, presidenti Thaçi është shprehur i gëzuar që Republika e Guineas për herë të parë ka

emëruar ambasador për Republikën e Kosovës. "E mirëpres avancimin e marrëdhënieve tona bilaterale dhe mbështes çdo thellim të bashkëpunimit dhe të afirmimit të Kosovës në Guinea dhe në tërë rajonin tuaj", u shpreh presidenti Thaçi.

Ambasadori Siradiou ka përcjellë urimet e presidentit Alpha Conde të Republikës së



Guineas dhe është shprehur i gëzuar për detyrën e re që ka marrë, duke shtuar se do të kërkojë mundësi për ta çuar përpara këtë bashkëpunim.

Presidenti Thaçi e ka falënderuar për njohjen e Kosovës nga Republika e Guineas dhe për përkrahjen që kjo republikë i ka dhënë Kosovës në organizatat dhe forumet ndërkombëtare.

Presidenti Meta kërcënon me një revolucion si ai në Rumani

TIANË, 20 SHKURT - Presidenti i Shqipërisë Ilir Meta akuzoi shumicën parlamentare se janë pasardhës të regjimit komunist dhe e bëri të qartë se nga 2 marsi, Shqipëria do të bëhet kuqezi, e jo më mavi, siç është aktualisht.

"Presidenti i Republikës po bën hetuesin vullnetar të SPAK-ut", tha ai pasi këshilltari i tij, Dervishi shpjegoi shkëljet.


"Mafia nuk mund të bëjë asgjë më shumë sesa të bëjë leckë Kushtetutën e vendit dhe Gjykatën Kushtetuese. Një vend pa Gjykatë Kushtetuese nuk ka Kushtetutë. Kjo situatë ka ardhur nga vendimet e keqmen-dura të Dvoranit.

Ata duan të gjitha pushtetet. Ka ngelur edhe kjo kalaja këtu, që e gjithë Shqipëria të bëhet mavi, as mavi, por kuqezi. Kush e do

këtë? Kjo kërkohet nga ata që e bënë Shqipërinë mavi për 50 vite të tëra, në një regjim që krahasohet me Korenë e Veriut sa i përket të drejtave të njeriut", tha presidenti.

Meta tha se Rumania i tregoi nëpërmjet revolucionit vendin diktatorit. "Shqipëria nuk do të bëhet më kurrë mavi. Do të bëhet kuqezi. Duke filluar nga këtu ku është, e gjithandej. Këta

mendojnë sikur shqiptarët janë lodhur dhe sikur janë dorëzuar, por këta nuk e dinë akoma se ky është një popull shqiptonjash dhe serrat kurrë nuk do të bëhen shqiptonja. Shqiptonjat do të mblidhen këtu më 2 mars e ta bëjnë Shqipërinë kuqezi. I ftoj shqiptarët për fëmijët e tyre, sepse është Shqipëria kështu, që sot kemi shpopullim", ishte thirrja e presidentit Meta.



KQZ-ja certifikon kandidatët për kryetar të Podujevës

Prishtinë, 20 shkurt (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka certifikuar tre kandidatët për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës. Kandidatët në

garë për të parin e Podujevës janë: Nexhmi Rudari nga LDK-ja, Shpejtim Bulliqi nga Lëvizja Vetëvendosje dhe Naim Fetahu nga PDK-ja. Zgjedhjet në Podujevë do të mbahen më 15 mars,

pasi Agim Veliu nga LDK-ja kishte hequr dorë nga kjo pozitë, pas emërimit ministër i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.



Shkarkohen 14 konsuj nëpër ambasada

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, ka shfuqizuar vendimet për 14 konsuj diplomatikë që ishin emëruar nga ish-ministri i Jashtëm Behgjet Pacolli.

Në njoftimin e MPJD-së thuhet se vendimi është marrë konform ligjeve në fuqi. "Ministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, duke u mbështetur në nenin 93, (paragrafi 4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe sipas neneve 10,11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, neni 53 (paragrafi 1) dhe neni 55 (paragrafi 1 dhe 2) të ligjit Nr. 05/L-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 23 (paragrafi 2), të ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 8 (paragrafi 1,4) të Rregullores 02/201, për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ka marrë këtë vendim për shfuqizimin e vendimeve të kundërligjshme, në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës", thuhet në njoftimin e kësaj ministrie.

Konsujt e shkarkuar nga ministri Glauk Konjufca janë: Xheraldina Rexhepi, konsulle

në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Vjenë/Austri; Festim Lushtaku, konsull në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Tiranë/Shqipëri; Kadri Balaj, konsull në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Podgoricë/Mali i Zi; Henor Pakashtica, konsull në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Sofje/Bullgari; Xhavit Gerbeshi, konsull në Konsullatën e Republikës së Kosovës në D u s e l d o r f / G j e r m a n i ; Ngadhnjim Makolli, konsull në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Kanberra/Australi; Ramiz Ismajli, konsull në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Abu Dhabi/EBA; Ismet Hajdini, konsull në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Pragë/Çeki; Modesta Imeri, konsulle në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Uashington/Shtetet e Bashkuara të Amerikës; Eshref Haxhiu, konsull në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Doha/Katar; Kadri Gërvalla, konsull në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Shtutgart/Gjermani; Lutfi Bilalli, konsull në Konsullatën e Republikës së Kosovës në Frankfurt/Gjermani; Liridon Sadrija, konsull në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Hamburg/Gjermani; dhe Diellza Hoti, konsulle në Ambasadën e Republikës së Kosovës në EBA.



Gjermania do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën me procesin e integritit evropian

PRISHTINË, 20 SHKURT (ER) - Ministri i Integritit Evropian, Blerim Reka, ka pritur të enjten në takim Anja Becky, udhëheqëse e Bashkëpunimit për Zhvillim të Ambasadës Federale të Gjermanisë, dhe Mark Barret, udhëheqës i projektit të GIZ-it "Përkrahje për procesin e integritit evropian në Kosovë", financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.

Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin e deritashëm, për përkrahjen e fuqishme të cilin e jep Gjermania, në



veçanti GIZ-i për procesin integruar dhe për rrjedhën e implementimit të projektit me MIE-së.

Me këtë rast ministri Reka ka falënderuar Becky për përkrahjen e vazhdueshme të Gjermanisë për Kosovën, respektivisht për procesin e integritit evropian pasi që avancimi në këtë proces i hapë rrugë perspektives së qytetarëve tanë.

Projekti: "Përkrahje për procesin e integritit evropian në Kosovë" gjatë këtyre viteve të fundit ka qenë thelbësor për ngritjen e kadrove institu-

cionalë dhe se GIZ-i do ta vazhdojë mbështetjen e MIE-së drejt zbatimit me prioritet të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit si dhe përgatitjen e administratës për aplikimin e ardhshëm për anëtarësim në BE.

Me këtë rast, Becky dhe Barret rikonfirmuan përkrahjen e GIZ-it në pajtim me prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në procesin integruar. Ata theksuan përkushtimin e projektit të GIZ-it për përkrahjen e Kosovës sepse ky është një proces i gjatë dhe ka shumë punë për t'u bërë.



AMBASADORI AMERIKAN NË PRISHTINË, PHILIP KOSNETT, NË TAKIMET QË KA PASUR ME LIDERËT INSTITUCIONALË TË KOSOVËS, KA KËRKUAR HEQJEN E TAKSËS 100 PËR QIND NDAJ PRODUKTEVE TË SERBISË DHE BOSNJË E HERCEGOVINËS

ShBA-ja insiston për heqjen e taksës

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë, Philip Kosnett, edhe një herë në takime të drejtpërdrejta u ka kërkuar liderëve shtetërorë heqjen e taksës 100 për qind për mallrat serbe. Në këto takime ai u ka treguar atyre për përfitimet që i ka Kosova nga heqja e taksës. Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar zëvendësimin e saj me parim të reciprocitetit. Ndërsa njohësit e rrethanave politike në vend kanë bërë thirrje për unitet nacional për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi

ambasadori Kosnett flet për rëndësinë e marrëdhënieve të ShBA-së me Kosovën, me fokus në avancimin e synimeve tona të ndërsjella për ta siguruar paqen, drejtësinë dhe prosperitetin, si dhe përfitimet ekonomike që vijnë duke eliminuar menjëherë tarifën, është thënë në njoftimin e ambasadës së ShBA-së në Prishtinë.

Ambasada Amerikane ka treguar se diplomati amerikan ka takuar edhe liderët e partive opozitare.

“Ambasadori Kosnett po vazhdon takimet me përfaqësuesit e qeverisë së re, ndërsa sot është takuar edhe me ministrin e Punëve të Brendshme, Agim Veliun. Ai është takuar me kryeministrin, kryeparlamentaren Vjosa Osmani dhe zëvendëskryeministrin Hoti

dhe Abazi si dhe me ministrin e Punëve të Jashtme, Glauk Konjufcën, si dhe do të takohet edhe me ministrat e tjerë. Ai po vazhdon takimet e rregullta edhe me partitë opozitare”, thuhet në njoftimin e Ambasadës Amerikane.

Për takimin me ambasadorin amerikan ka njoftuar edhe kryetarin e AAK-së, Ramush Haradinaj, i cili ka vlerësuar se ShBA-ja nuk duhet ta barazojë Kosovën me Serbinë. Në profilin e vet në “Facebook”, Haradinaj ka shkruar se barazimi në mes të këtyre dy vendeve nuk duhet të ndodhë sepse orientimet e tyre në politikë të jashtme kanë kahe të kundërta. “Ambasadorit Kosnett i thashë se është i mirëseardhur dhe i nevojshëm aktivizimi i ShBA-së në dialog. Shtetet e Bashkuara nuk duhet

ta barazojnë Kosovën me Serbinë si palë sepse orientimet tona në politikë të jashtme kanë kahe të kundërta. Përdërisa Kosova stoikisht qëndron prapa ShBA-së në të gjitha sfidat globale, Serbia vazhdon të jetë sateliti dhe arma kryesore e Rusisë në Evropë. I paraqita ambasadorit Kosnett nevojën për marrëveshjen finale që rezulton në njohje reciproke në kufijtë ekzistues dhe kjo duhet të përmbyllet sa më shpejt”, ka shkruar Haradinaj.

Lideri i AAK-së edhe një ditë më parë ka treguar qëndrimin përfundimtar të AAK-së për heqjen e taksës. Sipas tij, taksa duhet të hiqet vetëm në këmbim të njohjes së Kosovës nga ana e Serbisë. “Kjo taksë duhet të ofrohet me heqje vetëm në këmbim të Kontratës

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, ua ka bërë të qartë edhe një herë liderëve shtetërorë dhe atyre politikë, se taksën 100 për qind ndaj mallrave serbe duhet ta heqin. Për ta sqaruar

qëndrimin e ShBA-së rreth kësaj çështje, ambasadori amerikan të enjten ka takuar liderët shtetërorë dhe ata partiakë. Në këto takime diplomati amerikan ka treguar për përfitimet ekonomike të Kosovës me heqjen e taksës. “Në të gjitha këto takime, si në takimet e tij të rregullta me kryeministrin Kurti,

mbështet tarifat si masë ndëshkuese ndaj konsumatorit. Ai ka deklaruar se parimet e reciprocitetit që do të nxirren nga Qeveria e Kosovës do të jenë të bazuara në parimet e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) dhe Marrëveshjes për Tregti të Lirë (CEFTA). “Rozeta tashmë ka marrë vendim për ta krijuar grupin punues me anëtarët nga Departamenti i Tregtisë, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda e Afaristëve të Kosovës, Dogana, AVUK-u dhe Klubi i Prodhuesve të Kosovës. Ky grup do t'i përmbledhë të gjitha barrierat tregtare me Serbinë dhe do të vijë me rekomandim te qeveria. Porsa

të vijë në zyrën time këto rekomandime do t'i analizojmë dhe do të marrim vendim për largim të tarifës dhe vendosje të reciprocitetit. Ne jemi shtet i pavarur dhe sovran dhe do të veprojmë si të tillë”, ka thënë Kurti.

Ndërsa nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, i ka bërë thirrje qeverisë për heqje të taksës. Përmes një postimi në rrjetin social “Twitter”, Haziri ka shkruar se vendimet e vështira e bëjnë një udhëheqës të suksesshëm. “Koha për ta hequr tarifën. Vlerësimet për reciprocitetin shkojnë paralelisht. Koha për vendime të vështira, por të nevojshme”, ka shkruar Haziri.

Konsensusi nacional për dialogun, jetik për Kosovën

Analistët politikë kanë bërë me dije që sa më shpejt të dëgjohet këshilla amerikane për heqjen e taksës dhe rifillimin e dialogut. Ata kanë vlerësuar se për këtë proces konsensusi nacional është jetik për vendin.

Analisti politik Agon Maliqi ka vlerësuar se do të ishte gabim i rëndë nëse mendohet se Richard Grenell nuk do të merret më me dialogun Kosovë - Serbi pas avancimit të tij në detyrën e drejtorit të përkohshëm të Inteligjencës Kombëtare në ShBA. Në profilin e vet në “Facebook”, Maliqi ka shkruar se gjasat më të mëdha janë se Grenelli nga pozita e re do të t'i japë shtysë më të madhe këtij procesi. “Kjo nuk është një administratë tradicionale amerikane, operon gati si qeveri ballkanike. Në këtë moment është jetik një konsensus kombëtar, veçanërisht mes Kurtit (si njeriu me legjitimitetin më të madh politik) dhe Thaçit (si njeri me peshë që e ka imponuar veten në këtë proces), për hapat në vijim. Kjo qasje e deritashme e hezitimit të skajshëm (nga Kurti) dhe protagonizmit të tepërt (nga Thaçi) mund të na marrë në qafë keq. Kosova, e madhe sa një lagje e Stambollit, është duke e mbivlerësuar peshën e vet në këtë periudhë shkundjesh tektonike”, ka shkruar Maliqi. Ndërsa analisti tjetër politik

Faton Avdullahu ka theksuar se qeveria aktuale nuk po ngutet rreth dialogut. “Qeveria aktuale vazhdon të jetë ende konsistente në qëndrimin të cilin e ka shpalosur që në fillim z. Kurti në takimin e parë me ambasadorin Kosnett. Kurti në këtë takim ka thënë ‘nuk do të ngutemi me dialogun’, edhe përkundër faktit se z. Kosnett po në këtë takim ka konstatuar se duhet ‘të rifillojnë menjëherë bisedimet me Serbinë’. LDK-ja ka përgjegjësi shumë të madhe para qytetarëve dhe vendit tonë në krejt këtë farë qëndrimi që pati dhe po e mban ende z. Kurti. Pa LDK-në, LV-ja nuk do të bënte dot qeveri dhe z. Kurti nuk do të vinte në krye të saj”, ka shkruar Avdullahu në profilin e vet në “Facebook”.

Taksa prej 100 përqindësh ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës është vendosur në nëntor të vitit 2018 nga Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga ish-kryeministri Ramush Haradinaj. Kjo ka ndodhur si kundërpërgjigje ndaj fushatës agresive diplomatike të Serbisë për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare si dhe për tërheqjen e njohjeve të saj. Me vendosjen e kësaj takse, Serbia ka refuzuar ta vazhdojë dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën.

Institucioneve parashkollore pa licencë u ndalohe puna

PRISHTINË, 20 SHKURT - Gjatë vitit 2019 në Kosovë kanë operuar 30 institucione parashkollore private pa licencë. Pas identifikimit të tyre, në shkurt të këtij viti këtyre institucioneve u është ndaluar veprimtaria. Kështu thonë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit në Qeverinë e Kosovës. Po sipas kësaj ministrie, aktualisht janë 122 institucione private edukativo-arsimore parashkollore të licencuara, ndërsa në proces të licencimit dhe rilicencimit janë edhe 38 të tjera.

Ngjashëm edhe me sektorët e tjerë, edhe në këtë fushë Ministria e Arsimit thotë se aktualisht ka pak inspektorë të angazhuar qoftë për licencim apo edhe lidhur me atë se sa është stafi i kualifikuar për t'i edukuar fëmijët parashkollorë. Besa Bytyqi, zëdhënëse në Ministrinë e Arsimit, i tha “Radios Evropa e Lirë” se asnjë institucion edukativo-arsimor parashkollor privat nuk mund ta fillojë punën pa iu nënshtruar procedurave të marrjes së licencës në MASHT, pra pa u pajisur me licencë të punës. “Për të gjitha ato institucione që nuk e kanë zbatuar vendimin e ndërprerjes së veprimtarisë, lënda është dërguar në gjykatë. Pra, janë identifikuar 30 kopshte vetëm gjatë vitit 2019 pa licencë pune. Aktualisht janë 41 inspektorë të arsimit. Është e vërtetë që numri i inspektorëve është i vogël dhe numri i tyre pritet të rritet, pasi që ata kanë përgjegjësi të madhe, pra janë të obliguar të bëjnë sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar”, ka thënë Bytyqi.

Inspektorati i Arsimit, ka theksuar Bytyqi, e ka aktivitet të përditshëm identifikimin e institucioneve edukativo-arsi-

more parashkollore të cilat punojnë pa licencë nga MASHT-i dhe kudo që hasin të tilla e kanë obligim ligjor që ta mbyllin veprimtarinë e tyre derisa të njëjtat të pajisen me licencë.

Ndërkaq njohësi i çështjeve të arsimit, Rinor Qehaja, tha se në tërësi institucionet parashkollore, qofshin ato publike apo private, janë të anashkaluara nga institucionet qeverisëse. Ai shton se edhe investimi në edukim të mirëfilltë në fëmijërinë e hershme duket se është i kufizuar vetëm në debate, për mungesë të infrastrukturës ose atë të gjithëpërfshirjes, mirëpo shumë pak diskutohet se çfarë në të vërtetë u ofrohet fëmijëve. “Moslicencimi i kopshteve dhe çerdheve private paraqet neglizhencë institucionale që kërkon përgjegjësi institucionale. Është e patolerueshme që për grupmosha kaq të ndjeshme të anashkalohet në tërësi ky proces. Problemi shkon përtej licencimit dhe se Ministria e Arsimit duhet që përmes monitorimit ta garantojë sigurimin e cilësisë dhe mirëqenies së fëmijëve në këto institucione”, ka thënë Qehaja. Në anën tjetër, Dren Rexha, zyrtar nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), bëri të ditur se nga hulumtimi i fundit i bërë nga kjo organizatë, del se gjendja me institucionet parashkollore nuk është e mirë, derisa shton se edhe vetë prindërit nuk kanë kërkesa të larta, gjë që ndikon që kushtet në të cilat rriten dhe edukohen fëmijët, të mos jenë adekuate. Krahas cilësisë së edukimit që ofrohet në kopshtet e fëmijëve, çështje tjetër brengosëse mbetet edhe numri i vogël i këtyre institucioneve në nivel të vendit.



Finale për njohje reciproke në kufijtë ekzistues në mes të Kosovës dhe Serbisë, e jo për rikthim në proces dialogues pa afate e kornizë të cilin tashmë e kemi tejkaluar. Pozicionet për çështjet e tjera të hapura me Serbinë si krimet e luftës, reparacionet, të zhdukurit, suksesioni dhe çështje të tjera të inkuorpuara në ‘Librin e Madh’ janë të gatshme dhe të disponueshme”, ka vlerësuar Haradinaj.

Edhe i dërguari special i presidentit amerikan për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell dhe zyrtarë të tjerë të lartë amerikanë kanë kërkuar vazhdimisht nga qeveria e re që sa më shpejt të hiqet taksa dhe t'i jepet shansi dialogut.

Qeveria paralajmëron hapat drejt heqjes së taksës

Qeveria e Kosovës është duke punuar për heqjen e taksës 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës dhe për vendosjen e masës së reciprocitetit të plotë tregtar me Serbinë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në Konventën e Prodhuesve të Kosovës ka thënë se taksa ndaj mallrave serbe ka qenë vendim i qeverisë së kaluar dhe se qeveria që ai drejton nuk

Ministri Vitia dhe ambasadori italian diskutojnë për projektet e përbashkëta në shëndetësi

PRISHTINË, 20 SHKURT (ER) - Ministri i Shëndetësisë i Republikës së Kosovës, Arben Vitia, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Republikës së Italisë në Kosovë, Nicola Orlando. Siç ka njoftuar kjo ministri, në këtë takim u bisedua për bashkëpunimin në shëndetësi përmes

vazhdimin të projekteve mbështetëse, duke u bazuar në nevojat e sistemit shëndetësor në Kosovë.

Ministri Vitia ka falënderuar përmes ambasadorit Orlando shtetin e Italisë për projektet e deritanishme të realizuara në shëndetësinë e Kosovës, ndërkohë që bashkëbiseduesit kanë thek-

suar nevojën që të gjitha projektet e ardhshme të koordinohen, investimet të jenë efektive që të ndikojnë në ngritjen e kompetencës profesionale për profesionistët shëndetësorë në Kosovë, me qëllim që qytetarëve t'u sigurohen shërbime korrekte shëndetësore, cilësore dhe të sigurta.



LDK-ja bën publike emrat e pesë zëvendësministrave

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 SHKURT - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka bërë me dije se, pas trajtimit në kryesi të partisë, të çështjes së zëvendësministrave, ia ka ofruar kryeministrit Albin Kurti këto kuadro të LDK-së për zëvendësministra: Agim Krasniqi, zëvendësministër i Financave dhe Transfereve. Ekonomist. Ka punuar një kohë të gjatë drejtor i Departamentit të Buxhetit. Ka qenë zëvendësministër i Financave dhe ministër në detyrë i Financave. Anëtar i Këshillit të Ekspertëve të LDK-së. Xhavit Rexhaj, zëvendësministër i

Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Profesor. Ka udhëhequr grupin e ekspertëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës për hartimin e programit të arsimit të LDK-së. Ka mbaruar studime master në Varshavë e në Oxford në fushën e studimeve britanike, në Prishtinë e në Zagreb në fushën e letërsisë angleze dhe pedagogjisë, studimet e doktoratës në Universitetin e Tiranës dhe studimet postdoktorale në Universitetin e Nju Jorkut dhe të Los Anxhelosit. Ka mbaruar specializim në fushën e reformave të arsimit të lartë në Budapest. Ka qenë drejtor i Departamentit të Arsimit në Ministrinë e Arsimit. Është



profesor në Kolegjin AAB. Fatbardha Emini, zëvendësministër e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Juriste. Anëtare e Këshillit

të Drejtorëve në Komunën e Vitisë, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrës dhe tani drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit. Ka kryer studimet master. Anëtare e KP të

LDK-së. Ismet Beqiri, zëvendësministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Jurist. Ka qenë kryetar i Kuvendit Komunal të Prishtinës, drejtor i kompanisë publike Sport-marketingu, deputet i Kuvendit në disa mandate. Sekretar i përgjithshëm i LDK-së, tani nënkryetar i LDK-së. Florian Dushi, zëvendësministër i Drejtësisë. Jurist. Ka qenë sekretar permanent i Ministrisë së Drejtësisë, zëvendësministër i Drejtësisë, anëtar i KQZ-së. Ka ushtruar detyrën e Avokatit. Anëtar i kryesisë së LDK-së. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se kandidatet dhe kandidatët e tjerë për zëvendësministra do të caktohen në ditët e ardhshme.

Shefi i ri i EULEX-it ofron përkrahje për Këshillin Prokurorial

PRISHTINË, 20 SHKURT (ER) - Shprehja e gatishmërisë së lartë për bashkëpunim në proceset e përbashkëta mes Këshillit Prokurorial dhe EULEX-it për fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë dhe për çështjet që ndërlidhen me rëndësinë e monitorimit, këshillimit dhe mënyrës së trajtimit të sfidave dhe përpjekjeve që janë aktuale për sistemin prokurorial, ishin në fokus të diskutimeve në takimin e parë të kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, me shefin e ri të EULEX-



it, Lars-Gunnar Wigemark, pas marrjes së detyrës nga ana e këtij të fundit. Në këtë kontekst, duke uruar atë për detyrën e re dhe duke shprehur gatishmërinë e tij për bashkëpunim në kuadër të kompetencave të ndërsjella, kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Hyseni, ka njoftuar shefin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, Wigemark, për zhvillimet e fundit që ndërlidhen me zbatimin e prioriteteve strategjike dhe rritjes së efektivitetit, transparencës dhe llogaridhënies së sistemit

prokurorial. Edhe shefi i ri i EULEX-it ka shprehur gatishmërinë e tij dhe të stafit që drejton për ofrimin e mbështetjes për institucionet e sistemit prokurorial përmes rolit të monitorimit dhe këshillimit në rrugëtimin e tyre drejt fuqizimit të sundimit të ligjit në Kosovë në pajtim të plotë me praktikatat më të mira të BE-së. Shefi i ri i EULEX-it të enjten është takuar edhe me ministrin e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Agim Veliu.

MASH-T-i dhe IZha diskutojnë për praktikatat e implementimit të kurrikulave

PRISHTINË, 20 SHKURT (ER) - Një delegacion i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASH-TI) po qëndron për vizitë zyrtare në Tiranë, ku u mbajt një takim me zyrtarë të lartë dhe ekspertë të Institutit për Zhvillimin e Arsimit (IZha) të Shqipërisë.

Zyrtarët e lartë të MASH-T-it dhe të IZha-s diskutuan për nevojën e thellimit të bashkëpunimit të ndërsjellë, për sfidat dhe për praktikatat më të mira lidhur me implementimin e kurrikulave të përbashkëta në të dy vendet. Në këtë takim, ku ishte i pranishëm edhe drejtori i IZha-s, Gerti Janaqi, u fol edhe për

zhvillimin profesional të mësimit dhe me metodologji të reja të mësimit. Gjatë këtij takimi u fol edhe për angazhimet e përbashkëta që duhen bërë rreth përgatitjeve për organizimin e seminarit mbarëkombëtar për mësimin plotësues në gjuhën shqipe në diasporë.



Ministrja Haxhiu anulon provimin për noterë

Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, e ka kthyer në pikën zero procesin e emërimit të 79 noterëve për 35 komuna të Kosovës, i cili ka ndodhur në prill të vitit të kaluar. Ajo në një konferencë për media ka thënë të enjten se ky proces nuk ishte ligjor, transparent dhe objektiv. Po ashtu, ministrja Haxhiu ka njoftuar se ka anuluar edhe vendimin për emërimin e Komisionit për Përzgjedhjen e Noterëve si dhe të anëtarëve të Komisionit të Provimit të Noterisë. Ish-ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, e ka quajtur veprimin e ministres Haxhiu arbitrar dhe i cili, sipas tij, do të prodhojë pasoja juridike dhe administrative sepse paraqet shkelje flagrante të të drejtave të fituara nga qytetarët e Kosovës



konsulencës dhe monopoli i noterëve ekzistues. Ministrja e Drejtësisë e ka pasur premtim elektoral anulimin e këtij provimi për çfarë nuk kam asnjë problem, por ky veprim sot për sot arbitrar, do të prodhojë pasoja juridike e administrative sepse paraqet shkelje flagrante të të drejtave të fituara nga qytetarët e Republikës së Kosovës”, ka thënë Tahiri. Ai ka shtuar se në agjendën e tij politike e legislative gjatë kohës sa ka drejtuar Ministrinë e Drejtësisë, në përputhje të plotë me rekomandimet e Bashkimit Evropian, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe programeve të ndryshme të ekspertëve, ka punuar për avancimin e qasjes në drejtësi përmes një numri të madh projektligjesh, në mesin e të cilëve edhe atë për Noterinë. Ish-ministri Tahiri ka bërë me dije se këtë çështje do ta mbrojë në gjykatë, ku do të kërkojë njohjen e provimit të noterisë për të gjithë kandidatët që kanë kaluar provimin. “Njëkohësisht, i bëj thirrje secilit kandidat që ta shfrytëzojë të drejtën ligjore për ta mbrojtur interesin e tyre juridik përballë kësaj padrejtësie. Shihemi në gjykatë!”, ka deklaruar Tahiri.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 SHKURT - Ministrja e Drejtësisë në Kosovë, Albulena Haxhiu, ka anuluar procesin e noterisë të mbajtur në prill të vitit të kaluar nga ana e qeverisë që atëkohë udhëhiqej nga Ramush Haradinaj. Në një konferencë për media, Haxhiu ka thënë të enjten se procesi nuk ishte ligjor, transparent dhe objektiv. “Për këtë arsye unë si ministre e Drejtësisë nuk mund të vazhdoj një proces që ka pasur parregullsi dhe ka humbur

besimin. Nuk mund të vazhdoj me procesin ku shumica e kandidatëve që kanë kaluar provimin janë militantë të partisë, anëtarë ose miq të anëtarëve të Komisionit të Noterëve, ose anëtarëve të familjeve të tyre”, ka thënë ajo, duke shtuar se ky proces tashmë është duke u hetuar nga Prokuroria.

Ministrja Haxhiu sqaroi se një konkurs i ri do të shpallet më vonë. Ajo ka njoftuar se ka anuluar edhe vendimin për emërimin e Komisionit për Përzgjedhjen e Noterëve si dhe të anëtarëve të Komisionit të

Provimit të Noterisë.

Ministrja Haxhiu ka pohuar se këto vendime nuk janë hakmarrje, por janë si prodhim i parregullsisve që ka përcjellë konkursin në fjalë.

Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë ka reaguar ndaj të njëjtit proces në tetor të vitit 2019, duke i bërë thirrje qeverisë në largim që të përmbahet nga emërimi i ndonjë noteri publik dhe procesi t’i lihet qeverisë së re.

Ish-ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, gjatë mandatit të të cilit është realizuar procesi, përmes një postimi në llogarinë

e vet në “Facebook” e ka quajtur veprimin e ministres Haxhiu arbitrar dhe i cili “do të prodhojë pasoja juridike e administrative sepse paraqet shkelje flagrante të të drejtave të fituara nga qytetarët e Kosovës”. “Ministrja e re e drejtësisë ka vendosur ta anulojë procesin e rekrutimit të noterëve. Kështu pra, përmes këtij anulimi të pabazë, në mënyrë të paprecedent, duke mos i lënë ligjit të ri as edhe një rast të vetëm për zbatim, ka triumfuar përkohësisht logjika se ligji i ri duhet të ndryshohet. Kështu, ka dominuar mafia e

Thaçi: Rënia e Selman Vojvodës na bëri më të fuqishëm drejt rrugëtimit tonë për liri dhe pavarësi

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 SHKURT - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të enjten ka marrë pjesë në akademinë përkujtimore për dëshmorin Selman Vojvoda, i cili ishte vrarë 30 vjet më parë në demonstratat e vitit 1990 në qytetin e Mitrovicës. Presidenti Thaçi ka theksuar se një vit para se të vritej Selman Vojvoda në krye të përgjegjësisve kombëtare, duke demonstruar kundër Serbisë, më 28 shkurt 1989 Beogradi zyrtar i Millosheviqit suprimoi Kushtetutën e vitit 1974, duke ia hequr çdo atribut autonom Kosovës. “Ky degradim nuk kaloi pa rezistencë të fuqishme kombëtare në Kosovë. Kudo nëpër qytetet e Kosovës u bënë protesta të fuqishme. Ata që kanë qenë në atë kohë punëtorë, u kujtohet shumë mirë greva e minatorëve, grevat në të gjitha ndërmarrjet punonjëse, grevat dhe demonstratat e studentëve

gjithandej Kosovës, grevat dhe solidarizimi masiv popullor që po ndodhte anekënd Kosovës. Mund të them i gjithë kombi ishte bashkuar në mbrojtje të së drejtës së qytetarëve të Kosovës, por edhe afirmimit të të drejtave të tyre për të jetuar të lirë dhe të pavarur, siç jetojmë sot. Bilanci i atyre demonstratave çdo ditë kur ndodhnin ato, mbyllej me të vrarë, të plagosur dhe të arrestuar. Ky represion i Serbisë kishte filluar edhe më herët, por ishte sistematik, që nga shpërthimi i demonstratave të vitit 1981, nga studentët për t’u mbështetur nga të gjithë në Kosovë”, u shpreh presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit tha se goditja e institucioneve të Kosovës në atë kohë, burgosjet e intelektualëve, diferencimet dhe shtypja e përditshme u shtuan sidomos në vitet 1989 dhe 1990. “Ishte koha kur dominimi i Beogradit vazhdonte nëpër tërë republikat e ish-Jugosllavisë, me theks të



veçantë me dhunën që përdorte në Kosovë. Por, punëtorët kosovarë, minatorët e Trepçës, rinia studentore e Kosovës si forcë politike tradicionalisht kryengritëse, pra Lëvizja Studentore, u bashkuan dhe ajo priu në demonstrata dhe protesta në të gjitha qendrat urbane, por edhe kudo në Kosovë. Studentët e Universitetit të Kosovës dhe studentët kudo që studionin, qoftë në Prishtinë,

Mitrovicë, Pejë, Gjakovë apo Prizren, u solidarizuan me minatorët e Trepçës me forma të ndryshme, prej sakrificës më sublimë, grevës së urisë deri në demonstrata të hapura kundër policisë, ushtrisë dhe administratës së Serbisë”, ka thënë ai.

Rënia e Selmanit, sipas presidentit Thaçi, ka një simbolikë të veçantë për Drenicën, për Mitrovicën dhe

për gjithë Kosovën. “Ka një simbolikë të veçantë për Drenicën, sepse rënia e Selmanit ishte mesazhi më i qartë se Serbia nuk do të ndalet, se Serbia do të vazhdojë të vrasë të rinj e të reja të pafajshëm, studentë duarthatë, por me një frymëzim të qartë të rezistencës dhe lirisë. Rënia e Selmanit dhe ceremonia që u organizua me rastin e varrimit të tij ishte mesazhi i Kosovës, mesazhi i rezistencës, mesazhi i bashkimit të të gjithë njerëzve, në të njëjtën kohë ishte edhe mesazhi i pajtimit edhe në Drenicë, edhe në gjithë Kosovën, se vetëm të bashkuar do të mund të rezistonim dhe do të mund të fitonim përballë Serbisë. Pra, rënia e Selmanit na mobilizoi, na bashkoi, na pajtoi për të ecur përpara, për t’u kurorëzuar pastaj me liri dhe pavarësi. Simbolika e rënies së Selmanit për qytetin e Mitrovicës është i qartë, jeton edhe sot dhe do të jetojë përjetë e mot”, ka thënë Thaçi.

Murtezaj: ATK-ja është e përkushtuar t'u ofrojë shërbime profesionale bizneseve

PRISHTINË, 20 SHKURT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka mbajtur seminar me tatimpaguesit e rajonit të Prishtinës.

Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka thënë se janë të përkushtuar t'u ofrojnë bizneseve transparencë dhe trajtim të barabartë. "Tashmë është bërë traditë ky standard komunikimi përmes ATK-së dhe bizneseve. Dobi shumë e rëndësishme është edhe pjesa e komunikimit interaktiv. ATK-ja është e përkushtuar që t'u ofrojë bizneseve shërbime profesionale, transparencë dhe trajtim të barabartë", u shpreh ai.

Murtezaj ka theksuar se në vitin

2019 është ndalur trendi i borxheve prej 6 përqindësh. "Ne si ATK gjatë vitit të kaluar kemi qenë në proces të reformave dhe janë të atakuar dhjetë fusha. Në vitin 2019 është ndalur trendi i borxheve rreth 6 për qind. Tani kemi vetëm një qendër ku bëhet trajtimi i ribursimeve që vijnë nga të gjitha bizneset. Evazioni fiskal nuk është fenomen që dëmton vetëm zvogëlimin e mbushjes së arkës së shtetit, por është çrregullim edhe i tregut. Për bizneset e shëndosha është esenciale që të zvogëlohet në minimum ky evazion fiskal", ka deklaruar ai.

Drejtor i Departamentit të



Shërbimit në ATK, Sami Salihu, ka thënë se konsolidimi i mbledhjes së detyrueshme është përqendruar në

zvogëlimin e borxheve. "Një ndër risitë ishte konsolidimi i mbledhjes së detyrueshme dhe ATK-ja është e përqendruar për

ta zvogëluar stokun e madh të borxheve të vjetra dhe trajtimin e borxheve të reja. Përmes këtij divizioni mund të arrini marrëveshje edhe përmes pagesës me këste. Departamenti i mbledhjes së borxheve funksionin në mënyrë elektronike dhe faktori njeri shumë pak ka rol. Në divizionin e parë, rastet trajtohen për 20 ditë. Tatimpaguesit që kalojnë në divizionin e dytë konsiderohen tatimpagues me rrishtë, sepse këta janë të njoftuar me procedurat e mbledhjes. Ne ju sugjerojmë që borxhet të paguhet sa më shpejt, pra derisa jeni në fazën e parë dhe mos pritni të kaloni në fazën e dytë për t'u trajtuar", u shpreh Salihu.

FMN-ja konfirmon mbështetjen për BQK-në



PRISHTINË, 20 SHKURT (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka prituri të enjten në takim misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, i kryesuar nga Gabriel Di Bella, shef i misionit për Kosovë në kuadër të Departamentit Evropian të FMN-së dhe Stephanie Eble, përfaqësuese rezidente rajonale për Ballkanin Perëndimor.

Guvernatori Mehmeti i ka njof-

tuar të pranishmit me situatën aktuale në sistemin financiar të Kosovës në përgjithësi dhe sistemin bankar në veçanti, i cili vazhdon të jetë stabil dhe meritë të vazhdueshme. Ai ka falënderuar delegacionin për përkrahjen e vazhdueshme që Fondi Monetar Ndërkombëtar i ka dhënë Kosovës, në veçanti Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, për realizimin e detyrës së saj për nxitjen dhe mbajtjen e stabilitetit financiar. Gabriel Di Bella ka falënderuar

guvernatorin Mehmeti për bashkëpunimin e vazhdueshëm, ku kanë diskutuar për agjendën e përbashkët për muajt e ardhshëm si dhe për mënyrat e rritjes së mëtejme të bashkëpunimit ndërmjet FMN-së dhe BQK-së. Gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë delegacioni i FMN-së, përveç me zyrtarë të BQK-së, do të takohet me zyrtarë të lartë të institucioneve të Kosovës. Delegacioni i FMN-së përfundon vizitën më 26 shkurt.

Endrit Shala do ta drejtojë Komisionin Parlamentar për Ekonomi

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 SHKURT - Në Kuvendin e Kosovës të enjten është konstituuar Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri dhe Investime Strategjike. Ky komision do të drejtohet nga deputeti i Nismës Socialdemokrate, Endrit Shala, i cili mandatin e kaluar ka qenë ministër i Tregtisë dhe Industrisë. Gjithashtu, ky komision ka vendosur që çdo të martë të mbajë mbledhje në orën 11:00.

Anëtarë të Komisionit Parlamentar

për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri dhe Investime Strategjike do të jenë nga Vetëvendosje: Mimoza Kusari-Lila, Hekuran Murati, Elbert Krasniqi; nga LDK-ja deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi; nga PDK-ja: Ferat Shala, Memli Krasniqi; nga AAK-ja Pal Lekaj dhe nga Grupi 6+ Adem Hodza.

Ky komision në kuadër të fushëveprimit dhe përgjegjësisë do t'i shqyrtojë çështjet që kanë të bëjnë me fushën e energjisë, minierave, sektorit postar, telekomunikacionin, teknologjinë e



informacionit dhe komunikimit, ekonomisë digjitale, tregtisë, industrisë, trauizmit, mbrojtës së konsumatorit, naftës, mallrave strategjike, zone ekonomike, pronësisë industriale, ndërmarrësisë, marrëdhënies së punës, punësimin, sigurisë dhe shëndetit në punë, dialogut social, sektorit privat, investimeve të huaja dhe investimeve strategjike si dhe monitorimin e ndërmarrjeve publike.

Kuvendi i Kosovës në legjislaturën e shtatë do t'i ketë 14 komisione parlamentare.

Rritet niveli i ujit në liqenin e Batllavës

PRISHTINË, 20 SHKURT (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjetës "Prishtina" ka njoftuar se pas reshjeve të fundit të shiut niveli i ujit në liqenin e Batllavës është rritur. "Niveli i ujit në liqenin e Batllavës të enjten ka qenë 624.28 metra mbi nivelin e detit ose 10.72 metra nën nivelin e kapërderdhjes, që

do të thotë se pas reshjeve atmosferike të borës më 4 dhe 5 shkurt, ky liqe ka një ngritje prej 32 centimetrash, derisa niveli i ujit në liqenin e Badocit e ka ruajtur nivelin e ditëve të kaluara, nuk ka pasur as rënie dhe as ngritje. Të enjten ka qenë 639.46 metra mbi nivelin e detit ose 10.39 metra nën nivelin

maksimal të kapërderdhjes", është bërë me dije në njoftimin e kësaj kompanie. Kryeshefi ekzekutiv i KRU "Prishtina", Ilir Abdullahu, ka thënë se gjendja e furnizimit me ujë të pijshëm është e qëndrueshme, por ka kërkuar nga qytetarët që të kenë kujdes me përdorimin e ujit.



Shënohet 31-vjetori i grevës së minatorëve të “Trepçës”

Kurti: Do të punojmë fort që t'ia kthejmë namin gjigantit ‘Trepça’

Me rastin e 31-vjetorit të grevës së minatorëve të “Trepçës”, të enjten në Stantërg është mbajtur manifestimi qendror “Java e Minatorëve”. Përveç minatorëve grevistë dhe atyre aktualë, në këtë manifestim morën pjesë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, përfaqësues të ministrive, deputetë, drejtorë dhe asamblistë të Kuvendit Komunal të Mitrovicës. Kurti ka potencuar se greva e minatorëve është një ngjarje e cila shënoi një epokë të re, të cilën vazhdojmë ta kujtojmë me rezistencën e jashtëzakonshme të 1 300 minatorëve

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

MITROVICË, 20 SHKURT - Me rastin e 31-vjetorit të grevës së minatorëve të “Trepçës”, e cila shënon ngjarjen historike të minatorëve jo vetëm të “Trepçës”, por të tërë Kosovës, në Stantërg u mbajt manifestimi qendror “Java e Minatorëve”.

Përveç minatorëve grevistë dhe atyre aktualë, në këtë manifestim morën pjesë kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa

Osmani, përfaqësues të ministrive, deputetë të Kuvendit të Kosovës, drejtorë dhe asamblistë të Kuvendit Komunal të Mitrovicës.

Me këtë rast kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka potencuar se greva e minatorëve është një ngjarje e cila shënoi një epokë të re, të cilën vazhdojmë ta kujtojmë me rezistencën e jashtëzakonshme të 1 300 minatorëve. “Minatorët ishin minatorë me profesion, por ishin edhe avokatë me pasion. Minatorë sepse duhet të krijonin të ardhura për familjet e tyre, ndërkaq avokatë sepse

kishin marrë mbi supet e tyre mbrojtjen e popullit shqiptar duke e pasur parasysh faktin sepse ata kishin njohuri shumë të thella mbi sistemin e atëhershëm, dhe kështu nuk i duruan padrejtësitë të cilat iu bënë gjatë asaj kohe. Ne konsiderojmë se ‘Trepça’ është një thesar publik dhe ne si qeveri nuk do të ndalemi dhe do të punojmë fort në mënyrë që t'ia kthejmë namin gjigantit “Trepça”, ka deklaruar kryeministri Kurti. Ai ka thënë se guximi i minatorëve do t'u jepte zemër fillimisht studentëve e intelektualëve, mandej edhe

Ushtrisë Çlirimtare ku, sipas tij, shumë minatorë do të bëheshin edhe luftëtarë lirie e jo pak janë edhe dëshmorë të kombit.

Më tej, kryeministri Kurti theksoi se 31-vjetori i grevës së minatorëve kujtohet si një ngjarje e cila ruhet në mbamendjen tonë popullore si një ngjarje e cila ka zgjuar dhe ka unifikuar një popull rreth mbrojtjes së identitetit kombëtar e kulturor, rreth ruajtjes së pasurive dhe punës sonë. “Tash kemi një qeveri e cila do të kujdeset për pasuritë publike. ‘Trepça’ është thesar publik të cilin ne duam ta revitalizojmë dhe t'ia kthejmë shkëlqimin e saj”, ka deklaruar Kurti, duke shtuar se revitalizimi i “Trepçës” është mundësia edhe për bashkimin e qytetit, për të mirën e të gjithëve pa dallim. “Ajo që mund të them tash është se: ‘Trepça’ është aset strategjik i Republikës së Kosovës. ‘Trepça’ nuk do të privatizohet dhe në ‘Trepçë’ do të investojmë”, ka deklaruar Kurti.

Në fjalën e tij kryetari i Komunës

së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka theksuar se është kënaqësi e veçantë që ndodhet në mesin e minatorëve për ta kujtuar njëherë nga ngjarjet më të rëndësishme historike të rrugëtimit të Kosovës dhe qytetarëve të saj drejt lirisë dhe pavarësisë. “Para 31 vjetësh ju ishit ata të cilët e kundërshtuat sistemin e atëhershëm jugosllav, sistem që tentonte të na copëtonte dhe t'i mohonte të drejtat tona. Pas gjithë atyre vuajtjeve të cilat padrejtësisht iu bënë popullit tonë dhe minatorëve të Trepçës, ka ardhur koha që tani, me qeverisjen e re të udhëhequr nga kryeministri Kurti, të largohet korrupsioni dhe të gjitha parregullsitë që kanë ndodhur në të kaluarën, në mënyrë që t'u kthehet dinjiteti minatorëve dhe Minierës ‘Trepça’”, ka thënë kryetari Bahtiri.

Ndërsa kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka theksuar se minatorët e “Trepçës” e donin Republikën, prandaj e ngritën fuqishëm zërin ndaj okupuesit dhe kundër ndryshimeve kushtetuese të asaj kohe. “Ngjashëm edhe sot, minatorët dëshirojnë mbrojtjen e pavarësisë së Kosovës, integritetin territorial, sovranitetin e vendit dhe dinjitetin qytetar. Falë kësaj sakrifice dhe vlerave të cilat na udhëhoqën e që përkrah nesh i rreshtuan shtetet demokratike të botës, kjo ëndërr është realizuar dhe pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme. ‘Trepça’ është e paprekshme”, ka deklaruar kryeparlamentarja Osmani.

Menaxheri i “Trepçës”, Basri Ibrahim, pasi ka folur për historikun e “Trepçës”, ka thënë se vetëm kur të flitet për “Trepçën” që është kaq e madhe dhe me kaq histori, kuptohet sa të vegjël janë të gjithë ata që mundohen të punojmë në të. Ai ka bërë me dije se me djersën dhe vetëmohimin e minatorëve, shqiptarët që atëherë po shkruanin historinë e shtetit të Kosovës. Në anën tjetër, kryetari i Sindikatës së Minatorëve të “Trepçës”, Gani Osmani, ka kërkuar nga përfaqësuesit shtetërorë që të punojnë në të ardhmen për të mirën e minatorëve, sidomos rreth stazhit të tyre, sigurimit shëndetësor dhe pensionit familjar.



Klubi i Prodhuesve me kod të bizneseve kundër korrupsionit

PRISHTINË, 20 SHKURT (ER) - Klubi i Prodhuesve të Kosovës, në kuadër të Konventës së Prodhuesve, ka bërë edhe nënshkrimin e Kodit të Bizneseve Kundër Korrupsionit. Nëpërmjet këtij kodi anëtarët e Klubit të Prodhuesve janë zotuar se do t'i zbatojnë standardet më të avancuara të etikës, transparencës dhe të integritetit në aktivitete të tyre

biznesore, se do të shmangin me vendosmëri çdo formë të përfshirjes në raste të korrupsionit, ofrimit të dhuratave apo favoreve të tjera zyrtarëve publikë apo personave të tjerë zyrtarë apo privatë që kanë për qëllim sigurimin e privilegjeve apo përfitim të paligjshëm në favor të kompanisë.

Kodi Kundër Korrupsionit ka për

qëllim që t'i ndihmojë bizneset të implementojnë aktivitete të drejta, transparente dhe ligjore. Kodi në fjalë përkufizon norma, aktivitete dhe nxit motivimin e bizneseve për t'i përvetësuar dhe zbatuar standardet më të mira ndërkombëtare për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit nga ana e ofertës, përkatësisht korrupsionit nga ana e bizneseve.



Aliu priti në takim ambasadoren e Finlandës, pritet shtimi i bashkëpunimit

FERIZAJ, 20 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka pritur në takim të enjten ambasadoren e Finlandës në Kosovë, Pia Stjernvall. Fillimisht në këtë takim Aliu e ka falënderuar ambasadoren finlandeze për kontributin e shtetit që përfaqëson gjatë gjithë etapës së zhvillimit të Kosovës si dhe vullnetin e kurdoherëshëm që të mbështetë e shtyjë përpara agjendën integruese të Kosovës. Përveç prezantimit të potencialit me të cilin disponon Komuna e Ferizajt, kryetari Aliu, i cili

shoqërohej edhe nga kryesuesja e Kuvendit Komunal, Kristina Gashi-Bytyçi dhe drejtori i Arsimit, Afrim Llabjani, ka njoftuar ambasadoren Stjernvall edhe me sfidat me të cilat po përballet qeverisja lokale. Temë e diskutimit në këtë takim ishte edhe diaspora shqiptare në Finlandë, potenciali ekonomik i biznesit ferizajas me mundësinë e rrjetëzimit me ekonominë e tregun finlandez, projektet e ndryshme të binjakëzimit, veçanërisht ndërveprimet në fushën e arsimit, ku sistemi

finlandez paraqet modelin më të mirë të sistemit arsimor e çështje të tjera që për qëllim kanë organizimin e nismave komunitare në fuqizimin e të rinjve. Ndërsa ambasadorja Pia Stjernvall ka thënë se për Finlandën është me interes zbatimi i programeve për ngritjen e kapaciteteve në të gjitha levat e sistemit qeverisës në Kosovë. Në këtë kontekst, ajo ka konfirmuar gatishmërinë e shtimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme edhe me Komunën e Ferizajt.



Nis ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën "Carraleva" të kryeqytetit

PRISHTINE, 20 SHKURT (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se kanë filluar punimet për ndërtimin e një muri mbrojtës në rrugën "Carraleva". Kjo komunë ka theksuar se qytetarët kanë qenë të rrezikuar nga shembja e mundshme e kësaj

rruge. "Po ndërtohet muri i ri mbrojtës në rrugën 'Carraleva'. Nga dëmtimi i tij rrezikohet edhe shembja e rrugës, duke cenuar sigurinë e këmbësorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.



Nënshkruhet marrëveshja për renovimin e 10 shtëpive në Suharekë

SUHAREKË, 20 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, dhe përfaqësuesi i projektit të "Subvencionet për Eficiencë të Energjisë në Kosovë (SEEK)", kanë nënshkruar të enjten një memorandum mirëkuptimi për bashkëfinancimin e këtij projekti.

Qëllimi i projektit është zvogëlimi i konsumit të energjisë elektrike në sektorin e banimit, duke ndarë subvencione për njësitë e banimit që të investojnë në masa të eficiencës së energjisë dhe në burime të ripërtërishtme të energjisë. Me këtë rast, Muharremaj ka bërë me dije se

në bazë të këtij projekti do të rinovohen 10 shtëpi. "Fillimisht do të rinovohen 10 shtëpi të skamnorëve, ku do të rritet eficienta e energjisë", ka thënë Muharremaj. Ai ka theksuar se ky projekt është shumë i rëndësishëm dhe për këtë Komuna e Suharekës do të angazhohet në vazhdimësi.



Suma e Hyseni flasin për gjendjen në arsim

HANI I ELEZIT, 20 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, ka pritur në takim Halim Hysenin, ekspert i arsimit dhe drejtor i Qendrës për Avancimin e Performancës në Arsim (QPA).

Kryetari Suma dhe Hyseni kanë biseduar në lidhje me gjendjen në arsim për të cilën janë pajtuar se bazuar në raportet zyrtare, rezultatet në këtë sektor nuk janë të mira përkundër shumë investimeve dhe shumë programeve dhe kurrikulave të cilat janë implementuar nga paslufta e kënde.



Në takim, ku ishin prezent edhe nënkryetari Mallzum Qajani dhe Menduh Vlasi, drejtori i DKA-së, Halim Hyseni, i ka njoftuar udhëheqësit komunalë se kjo qendër ofron trajnime për aftësimin e drejtorëve sipas konceptit të shkollës së shekullit 21.

Latifi dhe përfaqësuesit e USAID-it diskutojnë për ngritjen e transparencës dhe llogaridhënies

RAHOVEC, 20 SHKURT (ER) - Në kuadër të projektit të USAID-it për komunat transparente, efektive dhe llogaridhënëse (TEAM), kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, me bashkëpunëtorë, ka pritur të enjten në një takim informues delegacionin nga ky projekt ku është njoftuar më gjerësisht rreth projektit. Në këtë takim është prezantuar qëllimi i këtij projekti që është ngritja e transparencës dhe llogaridhënies në bazë të vlerësimeve për performancë më të mirë. Qëllimi kryesor është ngritja e kapaciteteve sidomos në fushën e prokurimit publik.



Kryetari Latifi fillimisht ka falënderuar pjesëmarrësit për takimin si dhe ka shprehur gatishmërinë e tij për bashkëpunim të mëtutjeshëm, duke theksuar se ky projekt është shumë i rëndësishëm për Komunën e Rahovecit për shtimin e kontrollit efektiv në fushën e prokurimit publik.

(MOS)NDRYSHIMI I ALBIN KURTIT



Ismet RASHITI

Albin Kurti mund edhe të mos ketë ndryshuar, por gjithsesi ka ndryshuar pozita e tij nga kryetari i LV-së është ngritur në kryeministër të shtetit të Kosovës. Ky ndryshim vjen si obligim nga koha kur është nominuar kandidat për këtë post të lartë shtetëror deri te zgjedhja e tij kryeministër nga Kuvendi i Kosovës. Ky nuk mund të quhet ndryshim politik, por përgjegjësi shtetndërtuese me të cilën e ka ngarkuar vota e lirë dhe demokratike.

Në vend të një programi politik, Albin Kurti sot si përfaqësues shtetëror ka përpara Kushtetutën e Republikës dhe obligimet e domosdoshme ndërkombëtare!

Gjatë këtyre ditëve njëra ndër temat më të debatueshme dhe njëkohësisht më të pakuptimta në mjetet tona të informimit padyshim është tema e (mos)ndryshimit të Albin Kurtit.

Në radhë të parë debatet e tilla amatore nuk janë debate. Së

dyti, tema e (mos)ndryshimit të Albin Kurtit nuk është aspak serioze. Mbi të gjitha, mënyra se si flitet për këtë temë është krejt e pakuptimtë, madje e dëmshme për shoqërinë tonë. Kjo për arsye se pothuaj asnjëri nga analistët nuk e njohin problemin real nëse mund të quhet ndryshim apo jo mënyra e sjelljes politike e një politikani në kohë dhe pozita të ndryshme politike dhe shtetërore.

Në fakt, një zhurmë e tillë po bëhet për shkak se pjesa më e madhe e "analistëve" nuk e njohin fare filozofinë politike dhe strategjinë e Albin Kurtit. Një pjesë e "analistëve" nisen nga interesa të ngushta apo inate personale të cilat tek masa e gjerë popullore e intelektuale vetëm sa e rrisin autoritetin e z. Kurti.

Që ta analizosh mënyrën e sjelljes dhe nivelin politik apo shkencor të një personaliteti, duhet një përgatitje e përafërt intelektuale. Duke folur në mënyrë krejt periferike, jashtë konceptit politik e strategjik dhe në të shumtën e rasteve në mënyrë tendencioze, në fakt këto debate nuk kanë asnjë vlerë. Debatet e tilla, përveç një mjegulle të dëmshme për shoqërinë tonë, nuk sjellin asgjë pozitive, madje pa asnjë arsye e rëndojnë skenën politike me gjëra të kota. Kjo mënyrë e debatit dhe ky nivel intelektual i disa analistëve që nuk del përtej thashethemeve

në kafenetë e tymosura të Prishtinës.

Këto të ashtuquajtura debate, përveç një zhurme të padurueshme, nuk i sjellin asnjë të mirë shoqërisë sonë. Për shikuesit apo lexuesit e vëmendshëm, krijohet përshtypja se disa prej "analistëve", për të mbijetuar në skenë, nuk u shkon përshtati asnjë rezultat i askujt dhe aq më tepër bashkëpunimi dhe unifikimi aq i nevojshëm, i veprimtarive në mes institucioneve më të larta të Kosovës. Në fakt, Albin Kurti mund të mos ketë bërë asnjë ndryshim personal.

Ndryshimi ka ndodhur tek elektorati shqiptar, i cili me votën e tij e ka nxjerrë Albinin nga një udhëheqës partiak në një udhëheqës shtetëror. Pra, tashmë Albini është i njëjti njeri, madje mund të ketë edhe të njëjtat bindje politike, por si kryeministër ka përgjegjësi shumë më të mëdha dhe të pakrahasueshme me ato që ka pasur si kryetar i një subjekti politik. Albin Kurti si kryeministër programin e LV-së e ka shkruar në programin e përbashkët shtetëror të aprovuar në Kuvendin e Kosovës si institucioni më i lartë ligjvënës.

Ndryshimi i Albin Kurtit ka filluar me emërimin e tij si kandidat për kryeministër të Kosovës, programin e të cilit me shumicë e ka mbështetur

populli në zgjedhjet e 6 tetorit 2019.

Që nga ky moment Albin Kurti, në vend të një projekti politik, ka përpara një Kushtetutë shtetërore së cilës duhet përmbajtur dhe respektuar domosdoshmërisht. Nuk është Albini personi që ka ndryshuar, por është ngritja e pozicionit në nivel shtetëror, ku përfaqëson të gjithë qytetarët pa dallim gjinie, partie, komuniteti, ngjyre, feje. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton kufijtë shtetërorë, simbolet dhe kompetencat institucionale të cilat duhet të r e s p e k t o h e n domosdoshmërisht.

Pra, Albin Kurti mund edhe të mos ketë ndryshuar fare, por gjithsesi ka ndryshuar pozicioni i tij, ndaj assesit nuk ka vend të bëhet temë debati (mos)ndryshimi i Albin Kurtit. Në këto rrethana nuk mund të quhet ndryshim i Albin Kurtit nëse respekton himnin dhe flamurin shtetëror të Republikës së Kosovës. Aq më e pakuptimtë është zhurma që është ngritur lidhur me takimin e kryeministrit me presidentin e shtetit, z. Hashim Thaçi. Në fakt, ky është një zhvillim i ri pozitiv, më se i domosdoshëm për një shtet normal që synon Bashkimin Evropian. Evropa nuk e dëshiron një vend ku dominon mosdurimi politik e institucional, ku nuk respektohet rendi shtetëror.

Pra, bashkëpunimi në mes të autoriteteve shtetërore nuk është dëshirë, por është obligim dhe këtë obligim e kryejnë burrështetasit që sillen përtej interesave personale dhe partiake për interesin e përbashkët shtetëror. (Mos)ndryshimi i Albin Kurtit është i domosdoshëm edhe për shkak të përgjegjësisë që i ka dhënë populli për ta përfaqësuar shtetin në arenën ndërkombëtare.

Pavarësisht dëshirës apo jo të Albin Kurtit, kryeministri është i detyruar të takohet me burrështetas botërorë dhe ta përfaqësojë shtetin tonë ashtu siç duhet dhe në përputhje me rregullat dhe të drejtat ndërkombëtare. Aty mund të marrë edhe obligime të cilave duhet përmbajtur sipas rendit botëror dhe të drejtës ndërkombëtare.

(Mos)ndryshimi i Albin Kurtit për njerëzit normalë dhe institucionalistë nuk paraqet asgjë të veçantë. Kjo nuk është as temë për debat, por një farsë inatesh nga individë të ndryshëm të cilët është normale të ekzistojnë në çdo shoqëri, ndaj nuk duhet marrë seriozisht. E rëndësishme është që qeveria Kurti të përkushtohet aq sa mundet dhe sa ka fuqi për zhvillimin e vendit, të mos korruptohet dhe gjithsesi ta forcojë funksionimin institucional dhe të sigurisë.

Varrosen pesë anëtarët e familjes Bllaca, sot ditë zie në Gjilan

GJILAN, 20 SHKURT (ER) - Mijëra qytetarë dhe përfaqësues të institucioneve kanë marrë pjesë të enjten në ceremoninë e varrimit të pesë anëtarëve të familjes Bllaca në fshatin Cernicë të Gjilanit. Sipas Policisë së Kosovës, Valdete Bllaca, me profesion police, ka privuar të martën nga jeta me armën zyrtare dy prindërit dhe dy vëllezërit e saj.

Në ceremoninë e varrimit, nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, ka thënë se kjo tragjedi ka prekur zemrat e shqiptarëve kudo që janë në botë. "Në emër të kryetarit Haziri, familjes së gjerë Bllaca iu shpreh ngushëllimet më të sinqerta. Kjo tragjedi na ka tronditur të gjithëve. Kjo është humbje e madhe jo vetëm për familjen, por për mbarë popullin shqiptar", ka thënë Ismajli.

Ndërsa në nderim të kësaj familje, kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka shpallur të premtën ditë zie në këtë komunë. "Me këtë rast,



ndërpriten të gjitha aktivitetet kulturore e politike të planifikuar

për këtë ditë, si dhe do të vendosen flamujt në

gjysmështizë në të gjitha institucionet komunale", është

thënë në vendimin e kryetarit Haziri.

Turqia dhe Rusia rifillojnë bisedimet për situatën në Siri

ANKARA, 20 SHKURT - Ministri i Jashtëm turk, Mevlut Cavusoglu, tha se kishte disa përafime me Rusinë në bisedimet për rajonin Idlib të Sirisë, por shtoi se diskutimet nuk ishin ende në një nivel të dëshiruar. Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka kërcënuar se forcat turke do të ndërmarin një operacion "të menjëhershëm" në Siri, për t'i dhënë fund sulmit brutal të regjimit sirian, ndaj bastionit të fundit që mbahet nën kontroll nga rebelët antiqeveritar. Turqia mbështet rebelët që

luftojnë kundër forcave të presidentit Bashar al-Asad, i cili gëzon përkrahjen e Rusisë dhe Iranit. Duke folur për transmetuesin TRT Haber, Cavusoglu tha se Turqia dhe Rusia do t'i intensifikojnë bisedimet e tyre për situatën në Idlib në ditët në vijim, duke shtuar se Erdogan dhe homologu i tij rus Vladimir Putin mund të diskutojnë gjithashtu për këtë çështje. Organizatat humanitare kanë bërë thirrje për një armëpushim urgjent dhe një ndihmë ndërkombëtare, për gati

një milion njerëz, që po ikin nga sulmi i forcave qeveritare në provincën veriperëndimore të Idlibit. Në fillim të kësaj jave, Kombet e Bashkuara thanë se të shpërngulurit ishin kryesisht gra dhe fëmijë dhe paralajmëruan që foshnjat po vdisnin nga të ftohtit sepse kampet janë të mbipopulluara. Sipas Vëzhguesit Sirian për të Drejtat e Njeriut nga ofensiva e forcave qeveritare janë vrarë më shumë se 400 civilë që prej fillimit të muajit dhjetor 2019.



Debati i demokratëve, Bloombergu vihet në shënjestër

Në një debat të kandidatëve të Partisë Demokratike në Las Vegas, miliarderi i posahyrë në garën presidenciale, Michael Bloomberg, u vu shpejt në shënjestër, ashtu si edhe kryesuesi i garës, Bernie Sanders

WASHINGTON, 20 SHKURT - Të gjithë sytë ishin te Michael Bloomberg të mërkurën në mbrëmje në Las Vegas, ku gjashtë pretendentë të Partisë Demokratike morën pjesë në një debat mes tyre. Miliarderi i posahyrë në garën presidenciale u vu shpejt në shënjestër, ashtu si edhe kryesuesi i garës, Bernie Sanders. Bloomberg u kualifikua për debatin në NBC News pasi zyrtarët e partisë lehtësuan rregullat dhe ai u rendit i dyti në një sondazh të publikuar të martën, pas kryesuesit, senatorit të Vermontit, Bernie Sanders. Një republikan dikur, Bloombergu ka shpenzuar miliona dollarë të parave të tij në reklama dhe ka bërë krahasime



me presidentin Donald Trump. "Demokratët do të merrnin një rrezik të madh nëse thjesht zëvendësojmë një miliardar arrogant me një tjetër. Ky vend ka punuar për të pasurit për një kohë të gjatë, dhe i ka lënë gjithë të tjerët në baltë", tha senatorja Elizabeth Warren, ka njoftuar voa. Bloombergu tregoi eksperiencën e tij si një biznesmen i suksesshëm dhe ish-kryetar i bashkisë së Nju Jorkut. "Jam një

filantrop që nuk i trashëgova paratë e miya, por i bëra paratë, dhe unë po i shpenzoj ato për të hequr qafe Donald Trump, presidentin më të keq që kemi pasur ndonjëherë", tha Michael Bloomberg. Ish-nënpresidenti Joe Biden sulmoi politikën e luftës ndaj kriminit të Bloombergut në Nju Jork që vinte në shënjestër njerëzit në komunitetet e pakicave, të quajtur "ndalo dhe kontrollo". "Politika ishte e

neveritshme dhe në fakt ishte një shkelje e çdo të drejte që kanë njerëzit", tha ai. Ish-kryetari i bashkisë së South Bendit në Indiana Pete Buttigieg e përshkroi senatorin e Vermontit Bernie Sanders si shumë larg nga e majta për të fituar zgjedhjet. "Ajo që po përpiqemi të bëjmë është t'i japim më në fund një zë më njerëzve që pas 45 vjetësh pune nuk bëjnë një qindarkë më shumë sesa kanë bërë 45 vjet më

parë", tha senatori Sanders. Si t'i fitojnë demokratët zgjedhjet? Senatorja Amy Klobuchar ka një përgjigje. "Mund të emërojmë një grua si kandidate për presidente të Shteteve të Bashkuara. Mendoj se kjo do të na ndihmonte shumë në se tregonim këto vlera si parti", tha senatorja Klobuchar. Zgjedhjet paraprake në Nevada janë nesër (shtunë), dhe debati tjetër, në Karolinën e Jugut, të martën e ardhshme.

Merkeli: Sulmi që la pas vetes 9 të vrarë i motivuar nga racizmi

BERLIN, 20 SHKURT - Kancelarja gjermane Angela Merkel, tha të enjten se kishte gjurmë të shumta që dëshmojnë se sulmuesi që vrau nëntë persona një natë më parë në qytetin gjerman Hanau, ishte motivuar nga racizmi dhe ekstremizmi i krahu të djathtë, ndërsa theksoi se autoritetet do të bëjnë gjithë çfarë është e mundur për të sqaruar sulmin. Një person i armatosur qëllon natën e së mërkurës në dy bare ku shërbehet me nargilë në

Hanau para se të kthehej në shtëpi dhe sipas policisë, të vriste veten. Prokurorët federalë morën përsipër hetimet për vrasjet në këtë qytet që ndodhet në lindje të Frankfurtit. "Ka shumë shenja që sulmuesi ka vepruar me motive ekstremiste, raciste dhe nga urrejtja ndaj njerëzve me origjinë tjetër, fe ose paraqitje tjetër", u tha Merkel gazetarëve të enjten. "Racizmi është helm, urrejtja është helm dhe ky helm ekziston në shoqëri dhe është

shkaktar i shumë krimeve krimine", tha kancelarja. Disa nga të vrarët janë me origjinë turke, tha zëdhënësi i presidencës së Turqisë, Ibrahim Kalin. "Presim që autoritetet gjermane të ndriçojnë këtë rast. Racizmi është kancer kolektiv", shkroi ai në rrjetet sociale. Policia tha se sulmuesi besohet të ketë kryer vetëvrasje pasi është kthyer në apartamentin e tij ku është gjetur edhe trupi i pajetë i së ëmës.



SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:
• **Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës**

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.
Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.
Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju

mirëpresim në zyrat e reja! NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

Dear clients and interested parties,
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:
• **Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova**

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.
We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

Thank you for your understanding and welcome to the new offices!

OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

Dragi klijenti i zainteresovane strane,
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajucceg društva Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:
• **Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova**

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.
Me ćemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajucceg društva na gore navedenu novu adresu glavne



SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË


Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net

Enciklopedia 'Bardhësitë e Atdheut' - Aset dhe identiteti gjithkombëtar i Atdheut...

"Bardhësitë e Atdheut", është vlerë sublime, pasi aty prezantohet historia e lavdishme, por edhe krenare dhe tragjike e Popullit Shqiptar nëpër dekada e shekuj. Autori, kërkonn publikisht nga kryeministri, Albin Kurti që ta financojë ribotimin e kësaj vepre, e cila përfshin 30 mijë argumente, dokumente deh dëshmi gjithkombëtare nga vitet: 1878-2018... Në fokus të kësaj enciklopedie, janë heroinat, heronjtë, dëshmoret dhe dëshmorët e të tri luftërave të UÇK-së (1997-2002), në: Kosovë, Kosovë Lindore dhe në Maqedoni... Janë, gjithsej: 3.000 dëshmore dhe dëshmorë të tri luftërave të UÇK-së të fundshekullit XX dhe fillimit të shekullit XXI në trevat, krahinatd he trojet shqiptare ...

Nga: Ekipi Hulumtues, Dokumentues, Botues dhe Promovues i Enciklopedisë Gjithkombëtare, me 30 mijë dokumente, dëshmi dhe argument gjithkombëtare, "Bardhësitë e Atdheut" (1878-2018)

Autori, Reporteri dhe Veterani i UÇK-së, Afrim Mustafa, tashmë opinionit gjithshqiptar, por edhe më gjerë i ka dhuruar enciklopedinë e trojeve shqiptare, "Bardhësitë e Atdheut", e cila është e vetmja dhe e para e llojit gjithpërfshirës me heroinat dhe heronjtë e trojeve të atdheut në periudhat më të ndritshme dhe më të lavdishme të kombit tone... Siç kanë folur dhe shkruar intelektualë të niveleve të larta gjithkombëtare, gjeneralë të luftërave të UÇK-së, por veçmas, akademikët dhe historianët me nam, puna e Autorit të nderuar dhe të veçantë, publicistit të mirënjohur, Afrim Mustafa ka zgjatur përplot dy dekada për të sjellë në dritë enciklopedinë gjithkombëtare "Bardhësitë e Atdheut", e cila tashmë, përmban 30 mijë fakte, dokumente, dëshmi dhe argumente gjithkombëtare, me shumë interes dhe me shumë vlerë për të gjithë shqiptarët... Dokumentet, faktet dhe dëshmitë gjithkombëtare të Enciklopedisë së trojeve tona, "Bardhësitë e Atdheut", tashmë kanë marrë vlerësime shumë të larta, si nga:



Veprimtari dhe atdhetari, Gafurr Bytyçi, kryetar i Degës së Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK, në Ferizaj. Baca Gafurr, flet me shumë nderime për Enciklopedinë gjithkombëtare të trojeve shqiptare, "Bardhësitë e Atdheut", me autor, Veteranin dhe Reporterin e luftërave të UÇK-së, z. Afrim Mustafa

Akademikët: Esat Stavileci, Pajazit Nushi dhe Mehmet Halimi, pastaj nga gjeneralët: Shukri Buja,

Rrustem Berisha, Bislim Zyrapi, Kudusi Lama, Jakup Krasniqi, Rrustem MustafaAvdyl Mushkolaj, Avdyl Bajrami, Hajrush Kurtaj, Shemsi Sylja, e në veçanti nga historianët dhe veprimtarët e njohur: Dr. Agim Zogaj, dr. Fahrush Rexhepi, dr. Selim Daci, veprimtarët e njohur: Shefqet Dibrani, Behram Hoti, Lulzim Mulliqi, e plot e përplot të tjerë dhe nga anë të ndryshme të Shqiptarisë... Ndonëse pa përkrahje institucionale, deri tash Autori Afrim Mustafa, ka arritur që veprën e përmasave të veçanta dhe me interes për Kombin e Atdheut tone ta botojë dhe ribotojë gjashtë here, ndonëse me ekzemplarë të kufizuar. Ai ka treguar se ka kërkuar vazhdimisht përkrahje për ta ribotuar enciklopedinë te zyra e ish-



Njëri nga veprimtarët e mëdhenj gjithkombëtarë, Mikel Kuzhnini, bashkë me villain e TIJ, Simon Kuzhnini, e nderuar Autorin Afrim Mustafa dhe Enciklopedinë që e ka shkruar AI, "Bardhësitë e Atdheut", duke e promovuar në qytetin e Prizrenit, ku kishte mysafirë dhe të ftuar të shumtë... Mikel Kuzhnini, iku nga kjo botë, duke lënë pas veprimtari të bujshme humanitare e atdhetare dhe duke ndihmuar mijëra e mijëra bashkëkombas të vetë në mbarë trojet shqiptare... Vëllezërit, Mikel dhe Simon Kuzhnini, ishin dhe mbeten pasuria e veçantë humanitare dhe atdhetare për mijëra shqiptarë, kudo ku këta vepruan dhe punuan për shumë kohë...



Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, me Autorin, Afrim Mustafa dhe Enciklopedinë gjithkombëtare të trojeve shqiptare, "Bardhësitë e Atdheut", gjatë një takimi dhe komunikimi të ndërsjellë

kryeministrit Haradinaj, por asnjëherë, as përgjije nuk ka marrë... Në anën tjetër, Enciklopedia gjithkombëtare me mijëra fakte, dëshmi, fotografi, dokumente, biografi dhe argument nga vitet "1878-2018, deri tash është promovuar mbi



Xhavit Jashari, kryetar i SHFDUÇK, njëri nga Përfaqësuesit e Familjes emblematke dhe Historike, Jashari nga Prekazi, krenohet me enciklopedinë, e cila e bën krenar Atdheut tonë, "Bardhësitë e Atdheut"... Xhavit Jashari, foli me nderime të veçanta në Promovimet e enciklopedisë gjithkombëtare "Bardhësitë e Atdheut", me autor, reporterin dhe veteranin e UÇK-së, Afrim Mustafa. Ai bëri apel që institucionet tona, qendrore dhe locale ta financojnë ribotimin dhe përkthimin e veprë madhore gjithkombëtare, me 30 mijë argumente, dokumente dhe dëshmi dyshekullore të Atdheut

247 herë në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, por edhe jashtë vendit. Autori falënderon ata që e përkrahën promovimet e Enciklopedisë "Bardhësitë e Atdheut", si Kolegjin Universitar, UBT, me në krye rektorin, njeriun e vlerave të mëdha, dr. Edmond Hajrizi, kryetarin e Shoqatës Humanitare, "Diaspora" në Kosovë, Enver Avdyli (Komandant "Hoxha"), afaristët e suksesshëm nga Tirana, Behar Mane, (Plaza), Kadri Morinaj (Eurosig), Avni Ponari (Elsig), si dhe afaristin e njohur, Veprim Mustafa nga Gjilani (Fludi-Arsi-Cola). Për ta promovuar në Kosovë kontribuoi edhe FFK, me kryetarin, njeriun e shumë vlerave, Agim Ademi. Rëndësia e përkthimit të "Bardhësitë e Atdheut", është shumë e domosdoshme, andaj ai kërkon që Qeveria e Re, me në krye kryeministrin, Albin Kurti, ta përkrahë dhe ta financojë në misionin e tij të ribotimeve dhe përkthimeve të këtij publikimi shumëdimensional...



Autori, Afrim Mustafa, me motrën e Dëshmorit të Kombit, Esad Kastrati nga Zatriqi i Rahovecit, Merita Rrahim Kastrati. Nderime dhe respekt për këtë familje atdhetare dhe oër të gjithë dëshmorët e atdheut...



Bardhësitë e Atdheut"- me nipin e dëshmorit të kombit, esad Rrahim Kastrati nga Zatriqi i Rahovecit, Esadit e vogël, i cili e trashëgon emrin e xhaxhait të tij, dëshmor i atdheut, Esad Kastrati...

Esati, luftoi dhe ra heroikisht, për të jetuar përgjithmonë në zemrat tona, më 3 shtator të vitit 1998...



Autori, Afrim Mustafa, nderohet dhe mirëpritët, jashtëzakonisht nga familjet e dëshmorëve dhe heronjve të Atdheut... Ky ishte një takim ku autori i dhuron me shumë Respekt një ekzemplar të Enciklopedisë gjithkombëtare Familje së Dëshmorit të Kombit, Muhamet Brahim Muharremi, nga Drobeshi i Vitisë, e cila këtu vie nga fshati Lubishtë i Vitisë, fshat, i cili i dha goditje nëpër dekada armikut sllavoserb, duke i rezistuar përherë, deri në fitorene Lirisë nga UÇK, në qershorin e vitit 1999.. Në foto: Bashkëshortja dhe nëna e Dëshmorit të UÇK-së, Muhamet Brahim Muharremi, babai i Dëshmorit, Brahim Muharremi, (1940) një njeri shumë i ndershëm, i mençur dhe i veçantë në krejt Vitinë dhe më gjerë, Autori i mirënjohur, Afrim Mustafa, si dhe vajza e Dëshmorit, Muhamet Brahim Muharremi, profesoresha, Arianita Muhamet Muharremi. Arianita Muharremi, ndonëse ka mbaruar Fakultetin dhe është vajzë e dëshmorit, ende nuk po arrin të punësohet... Këto janë institucionet tona, e veçmas ato të Vitisë...!!!

I shtyrë nga Robert Elsie, Ismail Gagica përpilon hartat turistike për Kosovën

Bujar MEHOLLI

Vendi ynë Kosova, është padyshim njëri nga më të bukurit jo vetëm në Ballkan por dhe në mbarë botën, shkruan KultPlus. Edhe pse e vogël, Kosova është e rrethuar me bucuri të rralla të cilat veç kosovarëve ua tërheqin vëmendjen edhe të huajve, pra, vizitorëve nga e gjithë bota.

Poeti kombëtar Naim Frashëri i



këndon me aq mall bukurive shqiptarëve nga pozicioni i mërgimtarit dhe qëllimi i tij është që përmes vargjeve t'ia bëjë të ditur çdo shqiptari se vërtet ata kanë natyrë aq të bukur, kanë pasuri të tërë rreth vetes. Si auto-

janë me interes, me qëllim për ta zgjuar kureshtjen tek një i huaj për ta vizituar një qytet kosovar. Hartat prezantojnë vlerat më përfaqësuese të atij vendi, të njëjtat përditësohen vazhdimisht, dhe aty hynë rrugët, trashëgimia kulturore e institucionet e rëndësishme për një të huaj.

Për të folur më gjerësisht rreth këtyre hartave turistike, Gagica shprehet për KultPlusin, duke shpalosur mjaft gjëra me interes për vizitorët.

“Kemi filluar me realizmin e botimeve që t'i ofrojmë publikut kryesisht të huaj, në lëmin e turizmit”, tregon Gagica.

Tutje ai flet për hartën e Prishtinës e cila është botuar në vitin 2010 si edicion special.

“Në vitin 2010 ka qenë një botim special për hartën e Prishtinës dhe për ne ka qenë një test, pas së cilit vazhduam tutje duke pas parasysh mungesën e informacioneve në fushën e trashëgimisë kulturore”.

Hartat e tilla japin informacion për qytetin, veçantinë e atij vendi dhe njëkohësisht për gjërat me interes, një udhëzues për atë vend dhe objektivi bie tek vizitorët e huaj.



didakt, Naimi përmes natyrës përpiket t'i skalis ndjenjat patriotike. Natyra gjithmonë luan rol parësor në një pjesë të krijimtarisë së tij.

Kodra, pyje, lumenj, fusha të gjëra, e rrethojnë Kosovën dhe natyrisht që për një vizitor fjala vjen nga Japonia, kjo natyrë është grishëse. Megjithatë, ajo çfarë mbetet për t'u bërë nga shqiptarët është që bukuritë dhe gjërat interesante të dinë t'i promovojnë nëpër botë, të njëjtat t'i prezantojnë turistëve të huaj në mënyrë që ata të zbarkojnë dhe t'i shijojnë ato.

Andaj, gjeografi dhe hartografi Ismail Gagica përmes një iniciative që ka ndërmarrë tash sa kohë po synon t'i promovoj bukuritë kosovare.


Gagica merret me përpilimin e hartave turistike. Fillimisht ai përpiloi dhe botoi hartën e Prishtinës për të vazhduar më pas edhe me qytetet tjera.

Përmes hartave, një vizitues gjen mjaft informacion për një vend, dhe këto informacione lidhen kryesisht me turizmin dhe ato që

“Kemi pas mungesë vazhdimisht të këtyre botimeve, dhe i kemi bërë edhe në gjuhën shqipe. Fillimisht me hartën e Prishtinës, mandej kemi vazhduar ta eksplorojmë edhe Kosovën në tërësi, dhe e bëmë shpërndarjen e këtyre hartave”.

Gagica thotë se turistët e huaj kur vinë në Ballkan, kërkojnë që t'i eksplorojnë këto vende.

“Një kohë i kam shpërndarë në Shkup dhe Tiranë sepse turistët vinë në Ballkan dhe mandej



kërkojnë që ta eksplorojnë njërin dhe tjetrin vend, Kosovën Maqedoninë e veriut e Shqipërisë, të cilat janë atraktive por që shpeshherë nuk arrijmë t'i promovojmë sa duhet”, potencon ai.

Në pyetjen se këto harta a planifikohet që të plasohen edhe në

internet në mënyrë që t'ua lehtësojë vizitorëve të huaj, Gagica përgjigjet se “Ideja është që këto harta t'i bartim edhe në internet dhe t'i prezantojmë online, e ta largojmë botimin fizik, por megjithatë turistët siç duket e kanë kulturë që ta marrin botimin në duar”.

Studiuesi Robert Elsie padyshim ka rëndësi të veçantë në historinë e kulturës sonë. Ai është marrë me letërsinë shqipe, e përgjithësisht me kulturën shqipe.

Gagica thotë se Elsie është ndikuesi më i madh në përpilimin e këtyre hartave.

“Kam udhëtuar shumë me Robert Elsin dhe kemi bashkëpunuar me të në fillim.

Elsie ka realizuar librin me fotografi “Kosova një vend për t'u zbuluar” ku shfaqen bukuritë kosovare. Robert Elsie ka qenë një shtytje për mua që t'i hy kësaj pune sepse shpesh nëpër vendet tona nuk ka udhëzues. Ai më ka



përkrahur dhe më ka dhënë shumë kurajë, që të jem më realist në atë që prezanton, duke fituar në këtë mënyrë simpatinë e turistit”.

“Në krejt këtë rrugëtim, rolin kyç e ka luajtur Robert Elsie, sepse edhe ai kishte nevojë për hartat tona. Dhe unë i kam punuar të gjitha ato harta për të. Botimi i fundit i tij ka qenë hartat e fiseve shqiptare, të cilat janë përmbledh dhjetë udhëpërshkrimeve të tij, ndërsa hartat i kemi bërë në bashkëpunim me të sepse ai ka qenë studiues i mirë i kulturës tonë”, përfundon Gagica.

Këto harta si synim kryesor kanë promovimin e kulturës shqiptare në sytë e vizitorëve të huaj, gjegjësisht nxitjen e tyre. Në fillim të kësaj iniciative u bë harta e Prishtinës, por mandej u krijuan edhe hartat e qyteteve tjera, në të cilat shpërfaqen vlerat e atij qyteti, qoftë nga muzika, gjeografia, trashëgimia kulturore e të tjera.

/ KultPlus.com /



Stevenson: Nga idetë e fundit

Nga: Aurel PLASARI

Emri Robert Louis Stevenson (1850-1894) është tanimë ai i një shkrimtari botëror. Më së shumti i lexuar si shkrimtar aventurash ose ndryshe peripecish, – “Ishulli i thesarit”, “Shigjeta e zezë”, “Rasti i çuditshëm i doktor Xhekillit dhe zotit Haid” etj. – më pak është njohur si autor shënimesh udhëtimi, si eseist, si kritik letrar etj.

Edhe për vete prej romaneve të aventurave kam pas bërë të njohur me të qysh prej magjepsjes në fëmijëri nga “Ishulla e thesarit”, që në ato kohë nuk duhej qarkulluar: “Ishulla” ishte e ndaluar për shkak të përkthyesit të saj të përsyshur, Tajar Zavalanit. Po njësoj qenë të ndaluara, prej Zavalanit themelues të përkthimit modern shqiptar në vitet '30 të shekullit të kaluar, edhe “Zonja me kameliet”, edhe “Tartarini i Taraskonit”, edhe “Gobseku”, edhe “Sonata e Krojcerit”, madje edhe “Anna Karenina” e tij etj.

I pasionuar i udhëtimeve, i përfytyruar gati-gati si vagabond, vitet e fundit të jetës Stevenson i përfundoi duke u endur ndër ishujt e Paqësorit

Jugor. Aty në ishujt Samoa edhe u vendos, më së fundi, tok me familjen e përbërë nga e bija dhe i biri të gruas së tij prej martesës së saj të parë, tanimë e vdekur, Bella dhe Lloyd Osbourne. Këta e respektuan dhe e deshën “njerkun” si atin e tyre. Për këtë bir të sjellë nga gruaja, Lloydin dikur 15-vjeçar, Stevenson kishte pas shkruar të parën vepër të vet famëmadhe, “Ishulli i thesarit”, atë roman të cilin edhe Borges e paska përjetuar – para nesh – si një nga format e lumturisë në fëmijëri.

Thjeshtri i tij Lloyd Osbourne tanimë i rritur, që më mbas do të bëhej edhe vetë shkrimtar, i qëndroi pranë Stevensonit deri në fund duke e përkujdesur dhe duke ia plotësuar deri edhe amanetin ekscentrik për banesën pasvdekësore. Ai ka shënuar e treguar edhe bisedat më të fundit me shkrimtarin në ndërkohët e lira ndërsa ky shkruante të pambaruarin “Weir of Hermiston”, ndoshta kryeveprën e vet. Kuptohet, prej bisedash të tilla, që Robert Louis Stevenson nuk paskësh qenë thjesht ndonjë “aventurier” bredharak i dhënë mbas jetës nomade, por njeri mendimi të thellë. Dhe jo më kot me veprat e veta paskësh

parapëlqyer t'i ikte “realitetit borgjez” duke thurur ëndërrime me vise vetmitare gjithë magji. Një mbrëmjeje, ndërsa shëtisin para lëndinës së shtëpisë, shkrimtari i mirëbesohet Lloydit: “Nuk jam njeri me ndonjë talent të jashtëzakonshëm, Llojd. Kam filluar me mundësi shumë të pakta. Suksesi im i detyrohet zellit tim të jashtëzakonshëm për punë, falë të cilit zhvillova deri në skaj gjithë sa pata në vete. Kur një njeri fillon t'i përkryejë aftësitë e veta dhe vijon t'i përkryejë ato me ngulm të pareshtur, mund të bëjë mrekulli. Të gjithë e dinë, të gjithë e kuptojnë, e megjithëkëtë sa e vështirë është të gesh dikë që ta bëjë! E kam fjalën që ta bëjë deri në fund, siç e bëra unë. Në pati tek unë ndonjë gjë gjeniale ishte gjenia e punës.”

Një ditë tjetër, i ulur në verandë në karrigen e tij të xunkthit, i bën këtë pohim kërkësor: “Çdo shkrimtar që vlen diçka, vdes dhe rilind papushim. Dje po lexoja “Virginibus Puerisque” dhe m'u duk mjaft i mirë, por i lindur nga një dell që tanimë do ta kisha të pamundur ta ngjallja sërish aq sa do ta kisha të pamundur të fluturoja. Tani puna ime është më e thellë nga

ajo e dikurshmja, mund të mbërrij emocione të cilat asohere mezi i dija që ekzistonin. Kjo do të thotë se Stevensoni që shkroi “Virginibus” ka vdekur dhe është varrosur, madje prej shumë motesh.”

Atje, në ishujt gjysmë të egër të Paqësorit Jugor, shkrimtari shfryn para mikut Lloyd: “Sa keq që e përdorin francezët lirinë e tyre! Nuk shohin tjetër gjë që t'ia vlejë përpos trekëndëshit të përjetshëm; ndërsa ne, që kemi mëgojëzën në gojë si qentë, dhe një kënd vështrimi pafundësisht më të gjerë, jemi të dënuar ta injorojmë gjysmën e jetës që na kalon përbri. Ç'libra do të kishte mundur të shkruante Dickens po t'ia kishin lejuar! Përfytyro një Thackeray pa zinxhirë, të lirë si një Flaubert a një Balzac! Ç'libra do të kisha mundur të shkruaja unë vetë! Mirëpo neve na japin një kutizë me lodra e na thonë: ‘Nuk duhet të luani veçse me këto.’”

Një ditë tjetër: “Arma e borgjezisë është uria. Nëse ti si shkrimtar ose si artist shkon kundër opinionëve të tyre të ngushta, ata në heshtje e thjesht fare të heqin mjetet e jetesës. Nganjëherë pyes veten se sa persona gjenialë dënohen

në këtë mënyrë çdo vit.”

Kurse një mbasdite, ndërsa miqtë atypari luajnë tenis: “Ne nuk jetojmë për nevojat e jetës, për to në fakt askush nuk çan kokë; ne jetojmë thjesht për gjërat e tepërta, të kota [superfluities].”

Madje në një moment: “Spektakli më i trishtë i qytetërimit dhe për mendimin tim dëshmia më e madhe e dështimit të qytetërimit, është njeriu që mund të punojë, që do që të punojë dhe të cilit nuk i lejohet të punojë.” Shkrimtari vdiq më 3 dhjetor 1894 po në Samoa. Me ndihmën e vendasve që e adhuronin njeriun Stevenson, Lloyd Osbourne-i e varrosi aty, simbas amanetit, në një majë mali: së andejmi vështrohej deti përpara, mbas shpine një pyll zanafillor, humnera, ujëvara të largëta dhe një visore që, me gjasë, këmba e njeriut nuk e kishte shkelur ndonjëherë. Po asaj mbrëmjeje u ul e filloi të hidhte në një blocknote kujtimet me titull Vdekja e Stevensonit. Janë nga ato kujtime falë të cilave lexuesit mund t'i njohin shkrimtarët edhe prej jetës së tyre, sidomos mendimeve të tyre, jo vetëm prej teksteve “fikcionale”.

/ExLibris/

Hebrenjtë në viset shqiptare

Nga: **Monika STAFA**

Legjendat, tregimet e moçme dhe shkrimet e autorëve të lashtësisë tregojnë se ilirët dhe hebrenjtë të vendosur në dy brigjet e Detit Mesdhe, megjithëse i ndanin më shumë se 2000 kilometra kanë bashkëjetuar, kanë shkëmbyer mesazhe miqësie dhe kanë lënë tek njëri-tjetri gjurmë të ndërsjella, të cilat mbeten burim hulumtimi.

Nga fundi i shekullit XII p.e.s., shumë ilirë u shpërngulën nga gadishulli ilirik dhe zunë vend në Azinë e Vogël. Ndër këto fise përmenden Pelesët të cilët u vendosën në bregdetin jugor të Sirisë, nga mendohet se edhe vendi mund të ketë marrë emrin Palestinë. Përsa i takon traditës së lidhjeve të hershme të hebrenjve me ilirët, është shkruar vetëm kalimthi dhe në mënyrë fragmentare. Përkundër vëmendjes së merituar që studimet shqiptare i kanë kushtuar pranisë së kulturës helene, asaj latine apo osmane, kultura hebraike ka mbetur për dekada me radhë krejt mënjanë. Prej shkrimeve biblike-ungjillore, ka disa njohuri fillestare mbi apostujt e krishterimit të hershëm, ku përfshihet edhe apostulli Pal. Ndër të tjera aty thuhet se predikimet e para u janë prezantuar bashkësive hebraike në Perandorinë Romake, duke përfshirë edhe Illyricumin.

Informacionet e para për këtë marrëdhënie vijnë deri në ditët tona nga një legjendë e cila parë në sytë e studiuesve shërbeu si një referencë jo pak serioze. Hebrenjtë, sipas saj, nuk u zhdukën. Ata u strehuan në Iliri, popullsia e së cilës i ndihmoi skllevërit, që ishin hebrenj të humbur. Të dhënat arkeologjike na mundësojnë praninë hebraike në Iliri në një periudhë prej 15 shekujsh.


Zbulimi i sinagogës së Sarandës hedh dritë mbi ekzistencën e komuniteteve hebraike në Shqipëri të paktën që në fillimet e shekullit VI. Po ashtu, u zbuluan edhe disa rrënoja të një sinagoge të gjetur në qytetin e Elbasanit. Profesori i arkeologjisë, Myzafer Korkuti, shkruan në lidhje me një mbishkrim të lashtë hebraik të zbuluar në Durrësin antik, që ruhet në Muzeun Arkeologjik të qytetit. Të dhëna për mbishkrime të lashta hebraike ka edhe për Shkodrën, Tivarin, Lezhën, të cilat janë qytete historike dhe me traditë lëvizjeje në këtë kohë. Një tjetër sinagogë e lashtë është gjetur dhe në Kosovë, përkatësisht në Ulpianë, në afërsi të Prishtinës, por nuk ka të dhëna më shumë. Komuniteti hebre mesjetar i Durrësit përmendet për herë të parë gjatë shek. XIII, kur bëhej fjalë për familje hebraike që merreshin me tregtinë e kripës. Të dhënat mbi këtë komunitet i përkasin më tepër sferës tregtare, ku siç dihet hebrenjtë gjithmonë kanë qenë me famë. Më vonë, me

ndryshimin e rrethanave politike, roli i komunitetit të hebrenjve të Durrësit erdhi duke rënë dhe më tepër, derisa në fillimet e shek. XV ai përmendet në burimet e kohës si i paktë në numër dhe shumë i varfëruar.

Kalvari i hebrenjve i cili fillon të përshkallëzohet që nga koha e sundimit romak, është i mbushur me shpërngulje masive nga vendbanimet e tyre historike drejt vendeve të ndryshme të Perëndimit apo të Lindjes. Sulltan Murati I (1360-1389) pushton krahina të tëra të Ballkanit, por këto pushtime nuk dëmtojnë dhe aq komunitetin hebre që gjendej në këto territore. Sundimtarët e rinj ishin shumë tolerantë ndaj hebrenjve dhe i trajtonin ata në mënyrë të ndershme dhe shumë më mirë sesa sundimtarët ortodoksë të Perandorisë Bizantine. Ata shumë shpejt arritën të mësonin gjuhën turke duke u integruar lehtësisht në jetën shoqërore dhe ekonomike të rajonit. Bashkësitë hebraike filluan të ngrinin institucionet e tyre të arsimit duke tërhequr në to nxënës nga e gjithë perandoria, por dhe nga vende të tjera si nga Hungaria, Polonia dhe Rusia. Një fazë kjo e periudhës historike sa i përket hebrenjve të rajonit e cila është konsideruar unike dhe që nuk mund të krahasohet me asnjë periudhë tjetër.

Kontingjentet e refugjatëve hebrenj që mbërritën në shtetin osman nuk ishin homogjene nga pikëpamja e përkatësisë social-kulturore. Një pjesë e rëndësishme e tyre i përkiste degës Ashkënazit, e cila vinte nga vendet e Evropës Veriore dhe Qendrore si Franca, Gjermania, Hungaria etj. Një tjetër kontingjent të madh të shpërngulurve nga Evropa Perëndimore formonin hebrenjtë e degës sefarade (Sefardikë) me prejardhje nga vendet e Gadishullit Iberik (Spanjë dhe Portugali), të cilët pas vitit 1492, u vendosën në epiqendër të problemit hebraik duke krijuar qarqet antisemite të Evropës.

Gjatë shekujve pasues, mendja dhe puna e tyre e ktheu Ballkanin në një prej tokave më prodhuese në Mesdheun Lindor. Hebrenjtë u morën me tregti duke gëzuar të drejta të plota dhe jetonin e visheshin sipas mënyrës së tyre pa asnjë problem. Ata mund të udhëtonin në të gjitha anët e perandorisë lehtësisht duke mos paguar asnjë taksë. Dalëngadalë hebrenjtë ia dolën të menaxhonin tregtinë osmane, ndërsa vetë këta të fundit të administronin politikisht qytetet në përgjithësi. Kjo ishte një ndarje e punës që u përshtatej të dyja palëve, prandaj gjatë shek. XVI, Perandoria Osmane lulëzoi. Si dhe mund të kuptohet fare qartë, arsyeja kryesore e vendosjes së tyre ishte lehtësia e lëvizjes për transportimin e mallrave me vapor duke qenë se kushtonte më lirë. Italia ishte në atë kohë vendburimi kryesor për hebrenjtë e Shqipërisë dhe të Greqisë. Në fakt,



krahasuar me qytetet e tjera të Ballkanit, ato shqiptare nuk kanë pasur një fluks të ardhurish nga komuniteti në fjalë. Mendojmë se arsyeja lidhet me terrenin e ashpër e të pazhvilluar ekonomik. Studiuesi Kostantinos Giakoumis i përmend hebrenjtë si komunitet edhe në Elbasan. Ndonëse nuk jep shumë detaje ai evidenton si datë të mbërritjes së tyre në kërthizën e Shqipërisë, vitin 1501. Prania e hebrenjve në qytet evidentohet edhe nga emri i tregut të vjetër të qytetit, i cili njihet si "Tregu i çifutëve". Diplomati amerikan Herman Bernstein, në vitin 1934 tregonte se patriku i Kishës Ortodokse Shqiptare, Visarion Xhuvani, i kishte folur për një vendbanim të madh hebrenjsh shumë vite përpara në Elbasan, si dhe për një ndërtesë të madhe me Yllin e Davidit që kish qenë sinagogë dhe më vonë ishte përdorur nga osmanët si han. Ky i fundit njihet si "Hani i Shehetilës" dhe sipas tregimeve të banorëve në themelet e tij, mbi të cilat në vitin 1930 ishte ngritur pazari i Elbasanit, ishin gjetur monedha ari me shenja hebraike.

Ambasadori amerikan, më tej shkruante se kjo pjesë e Elbasanit ish njohur si qendër banimi e hebrenjve dhe se ortodoksët që banonin aty mbanin emra biblikë, si Abraham, Isak, Jakov, etj. Më pas, sipas kujtimeve të Visarionit, ai shkruante edhe për ndihmesën e dhënë prej hebrenjve në zhvillimin e qytetërimit dhe denoncoi persekutimet kundra tyre në vendet e tjera. Ai përmend edhe disa pjesë nga testamenti i vjetër hebraik, gjë që hedh idenë se Patriku Visarion mund të ishte me prejardhje hebrenjsh që jetonin prej vitesh në Shqipëri. Më tej, ambasadori amerikan Herman Bernstein shkruante se "në arkivat e qytetit të Elbasanit gjeta një dokument të vjetër të shkruar me dorë dhe mbajtur nga një turk, rreth 200 vjet përpara, i cili bënte fjalë për tregtarë të shumtë hebrenjsh që ishin përpjekur të shkëlqin ligjet turke dhe ishin ndëshkuar prej tyre". Në afërsi të fshatit Xibrakë, pranë Cërrikut të Elbasanit, në rrugën e cila të çon në Belsh, ndodhet një varr me qemer guri që quhej "Varri i çifutit" e që sipas gojëdhënave kish qenë tregtar. Në muzeun e Elbasanit ndodhet një tepsit dhe një sahan bakri me Yllin e Davidit dhe mbishkrime hebraishte.

Në Durrës, "metropol i Ilirikut",

dëshmohej një konsistencë dhe vazhdimësi më e plotë e pranisë hebraike. Për rolin dhe rëndësinë e tij, Durrësi kishte marrë përmasat e një kozmopoli: aty gjeje banorë bujtës të huaj, sa bizantinë, aq edhe venecianë, raguzianë, gjenovezë etj. Nuk mund të mungonin edhe hebrenjtë. Për një prani domethënëse të hebrenjve në Durrës flet qartë një dokument i vitit 1417 ku përmendet për herë të parë një "Judaica Duracchi". Me këtë emër në Venedik, "Judaica" quheshin në mesjetë lagjet e qyteteve italiane të rezervuara për hebrenjtë. Në Durrës por dhe në Vlorë e në qendrat e tjera urbane, hebrenjtë kishin statusin e bujtësit apo të banorit dhe jo atë të qytetarit që e kishin vendasit. Përgjithësisht, në Shqipëri nuk shquhen gjurmë të qëndrimeve diskriminuese e antisemite, siç ndodhte rëndom në Evropën e krishterë të asaj kohe. Shqiptarët ndër dokumente kanë qenë vlerësuar në të gjitha kohërat për tolerancën e vet ndaj minoriteteve. Kjo vlen si për popullin ashtu dhe për autoritetet. Këtu nuk mungonin t'i afronin përfaqësuesit e komunitetit hebraik deri edhe në detyra e poste prestigjioze. Këtu kemi padyshim një tregues të integritetit në nivelin më të lartë të hebrenjve në realitetin vendas. Integritet që ishte akoma dhe më i dukshëm në nivelet e tjera të jetës qytetare.

E njëjta gjë vijoi edhe më pas kur me dëbimin e parë zyrtar nga Mbretëria e Napolit (vitet 1510-1511), një masë e konsiderueshme hebrenjsh të shpërngulur nga territori i kësaj mbretërie, zbarkoi në mjaft pika të bregdetit shqiptar, duke u përqendruar kryesisht në qytetin e Vlorës. Të ardhurit rishtarë, ose krijuan bashkësi të reja, ose iu bashkëngjitën asaj ekzistuese duke përtërirë dhe zgjeruar radhët, tashmë të tkurrura tej mase.

Me historinë e hebrenjve të Vlorës ka qenë e lidhur ngushtë edhe ajo e bashkësisë hebraike të Beratit. Si dy qendrat kryesore urbane dhe administrative të sanxhakut të Vlorës (kanë ndërruar me njëra-tjetrën rolin e kryeqendrës së këtij sanxhaku), të dyja qytetet, përveç afërsisë gjeografike me njëri-tjetrin, kanë pasur lidhje ekonomike të veçanta midis tyre. Këto rrethana kanë përcaktuar edhe marrëdhëniet specifike midis bashkësive hebraike përkatëse. Ndryshe nga bashkësia

e hebrenjve të Vlorës, e cila në pjesën e saj dërrmuese i kishte rrënjët nga vendet perëndimore (Spanjë, Portugali, Itali), hebrenjtë e Beratit ishin të ardhur nga Vlora. Bashkësia hebraike e Beratit ishte e vogël, ndaj dhe mjaftohej me një sinagogë të vetme. Praninë e tyre aty e vërtetojnë dhjetëra dokumente të kohës.

Po si ndodhi kjo?

Kur Vlora u sulmua nga një flotë evropiane venedikase, hebrenjtë e këtij qyteti u larguan dhe shkuan në Berat për t'i shpëtuat shkatërrimit të qytetit bregdetar. Kjo çoi në rritjen e numrit të tyre në këtë qytet. Emigrantëve të ardhur nga Vlora, ashtu si dhe vendasve iu kërkua të paguanin taksa nga autoritetet turke, por të ardhurit nuk kishin me se të paguanin. Atëherë u vendos që ato të përballtoheshin nga hebrenjtë e Beratit. Kjo shkaktoi pakënaqësi dhe kundërshtim nga ana e tyre. Prania e komunitetit hebraik në Berat lidhet me emrin e një figure të jashtëzakonshme, të famshmit Sabatai Zevi, prijësin e një kryengritjeje të fshehtë të hebrenjve kundër Perandorisë Osmane, e mbiquajtur mesianike (nga Messiah). Ndonëse nga bashkëkohësit u konsiderua si mashtrues, ai ia doli të krijojë lëvizjen fetare me emrin e tij "sabatianizëm". Sabatai Zevi ishte udhëheqësi shpirtëror i hebrenjve. Ai predikonte juadizmin në fshehtësi për shkak të përndjekjes nga Perandoria Osmane. U kap nga turqit dhe u dënua me vdekje nga sulltani, por kjo solli lëvizje të mëdha tronditëse duke u shpërndarë në të gjitha komunitetet hebraike që jetonin në territoret osmane. Kjo e detyroi Portën e Lartë të tërhiqte vendimin e saj dhe ta dëbonte liderin mesianik të hebrenjve në Shqipëri së bashku me familjen e tij. Ai u dënua me internim të përjetshëm. Sabatai Zevi, i detyruar, u kthye në mysliman me emrin Aziz Mehmed. Disa studiues të huaj thonë se ka qenë i internuar në Berat ku dhe ka vdekur. Të dhëna gojore tregojnë se në lagjen Vakëf ka mbetur toponimi "Te varri i çifutit" pikërisht duke iu referuar varrit të tij. Por, nga disa autorë hebrenj të cilët e kanë studiuar mirë jetën e tij, ka dalë mendimi se ai mund të jetë varrosur në Ferrë të Sarandës ose në Ulqin. Varri i tij kërkohet për t'u bërë vend pelegrinazhi për besimtarët hebrenj. Si dhe kuptohet, lëvizja e tij pati një jehonë të gjerë në të gjithë pellgun mesdhetar e deri në Holandë. Sikurse ka provuar studiuesi hebre Gershom Gerhard Scholem në studimin e tij, 'Sabbatai Zevi - The Mystical Messiah', ai së bashku me luftëtarët e tij gjeti mbrojtje edhe mes shqiptarëve. Ai la gjurmët e tij kudo ku shkoi në qytetet shqiptare si në Vlorë, Berat apo dhe Ulqin./Telegrafi/

(Shkëputur nga libri "Hebrenjtë në Shqipëri")

E rrallë

Blokohet trafiku për një selfie

Një grup burrash krijuan trafik në një ndalesë në një rrugë të ngjeshur në Londër, në mënyrë që të mund të pozonin një selfie para supermakinave të tyre. Të katër burrat u vërejtën duke dalë nga një Lamborghini Aventador dhe tri Audi në Rrugën Qarkore Veriore A406 në lindje të Londrës të mërkurën pasdite.



Ata u panë në këmbë në mes të trafikut të zënë duke fotografuar veten me telefona.

FOTO E DITES




Banorët e një lagje periferike në buzë të qytetit verior sirian të Alepos kthehen në shtëpitë e tyre për t'i kontrolluar dëmet e shkaktuara nga luftimet midis forcave të regjimit dhe luftëtarëve rebelë. /AFP/

E jashtëzakonshme

Shkencëtarët zbulojnë 11 asteroide që mund ta godasin token

Një algoritëm kompjuterik i Universitetit Leiden në Holandë ka pikasur njëmbëdhjetë asteroide që më vonë mund ta godasin planetin tonë duke shkaktuar shkatërrim të paprecedentë. Si pasojë e orbitave të tyre kaotike ato nuk janë zbuluar nga sistemet amerikane të NASA-s. Asteroidet janë reth 100 metra në diametër dhe do të kalojnë



pranë planetit tonë pesë herë sa distanca mes tokës e hënës. Por, nëse ndodh incidenti, pritet të zhvillohet në vitet nga 2131 deri në 2923 në varësi të ndryshimit të orbitave të tyre.

BARSOLETA E DITËS



Polici: Pse nuk na keni lajmëruar më herët se është grabitur shtëpia juaj? Pronari: Njëherë mendova se motra ime është duke u bërë gati për të dalë në qytet, sepse kështu lëmsh e bën gjithë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan




Çdo natë në ora 20:00

STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
Regjia: J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30

THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.



DASHI

Falë Diellit dhe Marsit do të jeni në gjendje

të merreni me oferta interesante dhe komplekse të punës që premtojnë shpërblim dhe të ardhura të shkëlqyera.



DEMI

Sot do të ndiheni pak të vetmuar dhe të

lënë pas dore pavarësisht se në realitet nuk keni arsye pse të ankoheni.



BINJAKËT

Ditë e bukur kjo e sotmja për ju. Do

të jeni të lumtur, të kënaqur, mund të mendoni pozitivisht dhe ta shihni anën më të mirë të çdo situatë.



GAFORRJA

Në dashuri do të duhet të

bëni më shumë se zakonisht për ta tërhequr vëmendjen e personit që ju pëlqen më shumë.



LUANI

Paratë vijnë dhe shkojnë, kështu që

mos mendoni shumë. Marrëdhëniet intime në dashuri po thellohen edhe më shumë, por përpiquni të jeni shumë mirëkuptues me partnerin tuaj.



VIJGJËRËSHA

Me një gjakftohtësi më të

jashtëzakonshme ju do të menaxhoni një situatë mjaft delikate. Në dashuri, kur dëshironi, mund të jeni simpatik.



PESHORJA

Sot nuk do ta keni energjinë dhe prit-

shmërinë e duhur dhe do të ndiheni disi të nënshtruar. Ju mund të gjendeni në një situatë të pakëndshme.



AKREPI

Do të përballeni me pasion dhe dashuri,

miqësi dhe interesa, argëtim dhe kuriozitate të reja. Marsi ju mbush me energji për projektet tuaja.



SHIGJETARI

Hëna premton gjëra të shkëlqyera

dhe rezultate të mëdha në punë, veçanërisht nëse jeni të gatshëm t'i përvishni mëngët dhe të punoni siç duhet.



BRICJAPI

Shumë prej jush do të keni disa fitime

të papritura. Mbrëmje shumë dashamirëse për ata që janë në çift dhe të lumtura. Flirt për beqarët dhe të rinjtë.



UJORI

Takoni njerëz të aftë dhe do t'ju

ndihmojnë t'i shfrytëzoni burimet tuaja deri më tani të pashfrytëzuara. Merrni kohë për veten tuaj, përpiquni të mos krijoni frikë.



PESHQIT

Qielli sotëm ju ndihmon t'i demon-

stroni cilësitë tuaja dhe të arrini qëllime vërtet ambicioze. Përballë një zgjidhje, një vendim të rëndësishëm biznesi, ju do të dini se si të veproni.

Aktori i famshëm tregon pse është pënduar pas shkurorëzimit



Gjatë një intervistë për "New York Times", Ben Affleck tha se divorci është gjëja për të cilën është pënduar më shumë. Ai dhe ish-bashkëshortja Jennifer Garner finalizuan divorcin e tyre në vitin 2018 pas periudhave të gjata të krizës mes tyre. "Gjëja për të cilën jam pënduar më shumë në jetë është divorci. Ndjesia e turpit

është toksike. S'ka asgjë të mirë që vjen si pasojë e turpit. Është vetëm një ndjesi që ta ulë vlerësimin për veten", u shpreh aktori, referuar problemeve me alkoolin dhe paqëndrueshmërisë emocionale. Ylli i filmave sot është rikuperuar, por thotë se pija ishte një nga shkaqet që shkatërroi martesën e tij me Garnerin.

Lana Del Rey anulon turneun në Evropë dhe Mbretërinë e Bashkuar



Lana Del Rey ka anuluar gjithë turneun e saj evropian dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Këngëtarja ka njoftuar për këtë lajm "me keqardhje", duke përmendur sëmundjen si arsye. "Më vjen keq që i la të gjithë në minutën e fundit, por

kjo sëmundje më ka befasuar dhe kam humbur plotësisht zërin tim këndues. Mjeku ka këshilluar katër javë pushim për momentin. Unë e urrej të lë të gjithë, por duhet të bëjë më mirë. Ju do Lana", ka shkruar ajo në rrjetet sociale.



Kim Kardashiani merr sërish vëmendje

Ajo ka miliona adhurues në rrjetet sociale. Ylli televiziv Kim Kardashin di gjithmonë se si të bjerë në sy. Së fundmi ajo

u shfaq rrugëve të Los Anxhelosit tejet tërheqëse. 39-vjeçarja kishte veshur një fustan me ngjyrë të verdhë, të ngjitur për trupi.

Jenna Dewan fejohehet me Steve Kazee



Zilet e dasmës po bien për Jenna Dewan dhe babanë e Kardashshëm, Steve Kazee. Aktorja 39-vjeçare e "Step Up", e cila po pret fëmijën e parë me Kazee, 43-vjeçar,

njoftuan për fejesën e tyre në rrjetin social "Instagram". "Një jetë të tërë për të dashuruar dhe rritur me ty. Ti ke zemrën time", ka shkruar krahas fotografisë Dewan.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Kosova triumfon ndaj Islandës



PRISHTINË, 20 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll e ka fituar ndeshjen e parë të parakualifikimeve për Botërorin 2023. Të enjten mbrëma në Prishtinë, Kosova fitoi ndaj Islandës me shifrat 80:78. Kështu "dardanët" kanë bërë hap të rëndësishëm drejt kalimit me sukses të raundit të parë parakualifikimeve. Kosova të dielën luan në udhëtim ndaj Luksemburgut. Dy të parët në grup, ku bënë pjesë edhe Sllovakia,

kalojnë tutje. Kosova ka qenë vazhdimisht në epërsi në dy periudhat e para. Islandezët janë afruar në vetëm një pikë në fund të çerekut të dytë ndërsa në të tretin kaluan në epërsi të lehtë. Por lojtarët e Kosovës u kthyen shpejtë dhe kaluan sërish në epërsi. Edhe në çerekun e katërt Islanda kishte epërsi të lehtë, por në minutat e fundit "dardanët" ishin më të fokusuar. Epërsia arriti deri në nëntë pikë në minutat e fundit të

ndeshjes. Në fund dallimi ishte vetëm dy pikë, 80:78. Drilon Hajrizi ishte më i dalluari te Kosova me 16 pikë, tetë kërcime e gjashtë asistime. Erjon Kastrati realizoi 10 pikë, tri kërcime e pesë asistime, kurse më efikas ishte Dardan Berisha me 18 pikë. Në këtë ndeshje në postin e selektorit të Kosovës debutoi greku Christos Marmarinos. Te Islanda është dalluar Tryggvi Hlinason me 16 pikë e 12 kërcime.

SHKURT

Renditja e re e FIFA-s, ja ku renditen Shqipëria dhe Kosova

FIFA ka publikuar renditjen e re për të gjitha kombëtaret, ku ka shumë pak ndryshime për shkak të angazhimeve të pakta nga publikimi i fundit më 19 dhjetor të vitit të kaluar. Shqipëria renditet në vendin e 66-të me 1365 pikë, duke mos pasur ndryshim nga renditja e publikuar më parë. Ndryshim nuk ka pasur as për Kosovën, me "dardanët" që renditen në vendin e 115 me 1 174 pikë. Në vendin e parë qëndron Belgjika me 1 765 pikë, e ndjekur nga Franca me 1 733 pikë dhe Brazili në vendin e tretë me 1 712 pikë. Italia renditet në vendin e 13-të me 1 607 pikë.

Formacioni i javës në Ligën e Kampionëve

Në mesjavë janë zhvilluar katër ndeshje të Ligës së Kampionëve të fazës së 1/16 të finales. UEFA e ka publikuar formacionin e javës në Ligën e Kampionëve, që dominohet me lojtarët e Atalantës. Formacioni: Gulacsi, Laimer, Hateboer, Felipe, Lodi, Freuler, Saul, Cheryshev, Iliqi, Pasaliq, Haaland.

De Biasi: Hysaj ishte një nga më të mirët

Ish-trajneri i Kombëtares së Shqipërisë, Gianni De Biasi, së fundmi ka folur për "Casanapoli.net" duke kujtuar periudhën kur ishte në krye të kuqezinjve. Strategu italian vlerësoi Hysajn si një nga futbollistët më të mirë në vitin 2016, kur shkuan në Evropian. "Elseid është një nga futbollistët më të rëndësishëm të ekipit, por nuk dua të them se është më i rëndësishmi, pasi nuk më pëlqen që të bëj renditje. Në atë skuadër të gjithë ndihmonin një-tjetrin. Nuk ishte e rëndësishme se kush luante dhe kush jo. Unë i përzgjidhja në bazë të formës momentale. Kemi arritur një gjë unike duke kaluar një grup shumë të vështirë", ka kujtuar De Biasi.

Ferizaj në bisedime me Sokolin

FERIZAJ, 20 SHKURT - Skuadra e Ferizajt vazhdon të jetë pa trajner pas largimit të Bekim Isufit. Klubi i Superligës ka konfirmuar nëpërmjet një njoftimi në faqen zyrtare se janë në

bisedime me Bylbyl Sokolin, i cili edhe në të kaluarën me sukses e ka drejtuar Ferizajn. "Klubi ynë është në bisedime me trajnerin e mirënjohur vendor Bylbyl Sokoli për të udhëhequr FC

Ferizaj në sezonin pranveror. Bisedimet janë duke vazhduar akoma dhe për momentin nuk ka asnjë zyrarizim. Për çdo ndryshim do të njoftoheni me kohë në faqen zyrtare të klubit tonë",

thuhet në njoftimin e Ferizajt. Gazeta ka mësuar se marrëveshja mes Ferizajt dhe "Profës" është shumë afër dhe se ai do të jetë trajneri i kësaj skuadre në vazhdim të kampionatit.



Akuzohet presidenti i PSG-së

PARIS, 20 SHKURT - Nuk ka paqe për Paris SG. Përveç problemeve në skuadër dhe "markimit" të fortë që i bën UEFA për "fair-play financiar", klubi parisien duhet t'i bëjë llogaritë edhe me akuzat për korrupsion që rëndojnë mbi

presidentin Nasser Al Khelaifi. Ky i fundit është pronar i platformës televizive "Bein Sport" dhe kjo kompani ka sjellë probleme për sheikun, pas përfundimit të hetimeve nga autoritetet zvicerane për të drejtën televizive të Botërorit

2026 dhe 2030. Sipas akuzës, Al Khelaifi ka arritur të fitojë të drejtën e transmetimit nga platforma e tij televizive, duke korrupuar zyrtarët e FIFA-s. Një prej tyre, ish-sekretari Jerome Valcke, që shpeshherë kishte përdorur vilën private të

sheikut në Sardegnë. Për autoritetet zvicerane, pronari i Paris SG është avantazhuar nga Valcke, edhe ky nën akuzë për korrupsion dhe falsifikim dokumentesh pas skandalit që tronditi nga themelet qeverinë botërore të futbollit.



Ministrja Dumoshi: Ekipi olimpik i Kosovës do të përkrahet nga shteti



PRISHTINË, 20 SHKURT - Ministrja Viora Dumoshi ka pritur në takim drejtuesit e Federatës së Mundjes së Kosovës (FMK), të kryesuar nga Naim Muja dhe mundësin Egzon Shala, i cili ka marrë zyrtarisht njoftimin nga Federata Ndërkombëtare e Mundjes që ka arritur normën olimpikë. Kësaj, ekipit të sportistëve nga Kosova në Lojërat Olimpikë "Tokyo 2020" i shtohet edhe një sportist me normë olimpikë. Me këtë rast, ministrja Dumoshi e uroi mundësin Egzon Shala dhe

drejtuesit e FMK-së për këtë arritje dhe i dëshiroi suksese në paraqitjet në LO "Tokyo 2020". "Ekipi olimpik do ta ketë mbështetjen e plotë të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) ngase paraqitja në Japoni nuk është vetëm personale, por është prezantim edhe i shtetit të Kosovës dhe porositi që sportistët të përgatiten dhe të garojnë në mënyrë dinjitoze në këtë ngjarje të madhe sportive ndërkombëtare", ka thënë Dumoshi. Ministrja u shpreh se programi

dhe politikat për sportin e Kosovës që ka në plan MKRS-ja do të ndikojë drejtpërsëdrejti në avancimin e kësaj fushe të rëndësishme qoftë në cilësi ashtu edhe në masivizim. Ndërsa, nga ana e tij, kryetari Muja e uroi ministrin për marrjen e detyrës së udhëheqjes së MKRS-së duke i dëshiruar mbarëvajtje të punës dhe realizim të synimeve. Ai u shpreh se presin që ministria dhe qeveria në tërësi ta rrisë mbështetjen dhe ta kthejë syrin edhe më shumë kah fusha e sportit.

Olimpiada në dilemë, shkak coronavirusi

TOKIO, 20 SHKURT - Drejtuesit e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC) dhe organizatorët e Lojërave Olimpikë "Tokyo 2020" u shprehën se nuk ka asnjë "plan B" për të shpëtuar këtë event në rast se coronavirusi do të vazhdojë të përparojë me këto ritme. Virusi që për momentin ka një impakt shumë të madh në Kinë mund ta pengojë zhvillimin normal të Olimpiadës që nis pas pesë muajsh. "Organizata Botërore e Shëndetësisë na ka bërë me dije se nuk ka asnjë rrezik apo arsye që ne t'i anulojmë Lojërat Olimpikë. Unë jam 100% i bindur se Olimpiada do të zhvillohet sipas planifikimit", ka thënë John Coates, shef i misionit të IOC në Tokio. Ai ka inspektuar të gjitha vendet ku do të zhvillohet kjo Olimpiadë,



duke thënë se për momentin nuk ka vend për panik. Gjithsesi, 1 400 viktimat e deritanishme nga coronavirusi mund të kenë impakt negativ në rast se gjendja përkeqësohet. "Ne e monitorojmë çdo ditë situatën. Unë nuk mund të

parashikoj se çfarë do të ndodhë pas disa muajsh, por të gjithë e dimë se po bëhet maksimumi që ky virus të ndalet. Ne nuk kemi një 'plan B' për Olimpiadën, ndaj do ta vazhdojmë rrugën e nisur", ka deklaruar Coates.

SHKURT

Honda 'blindon' Marquezin

Kampioni i botës në Moto GP, Marc Marquez, ka rinovuar deri në vitin 2024 kontratën me motorin japonez Honda. Palët kanë zyrtarizuar të enjten marrëveshjen. Kontrata e pilotit spanjoll skadonte në fund të këtij sezoni, por ai do ta vijojë bashkëpunimin me Honda edhe për katër vjetët në vazhdim. "Jemi të lumtur që Marc do të qëndrojë me ne. Ai është dhe do të mbetet pjesë e familjes Honda. Kemi disa muaj që bisedojmë për rinovimin dhe gjetëm gjuhën e përbashkët për të vijuar edhe më tej së bashku", ka thënë Nomura, presidenti i Hondas. Marc Marquez e ka nisur karrierën në Moto GP në vitin 2013 me Honda, duke fituar 6 tituj kampionë në total. "Jam krenar për këtë marrëveshje të re me Honda. Falë kësaj kontrate të re jam më i qetë dhe mund ta vazhdoj garën për t'i arritur objektivat e mi", ka deklaruar Marquez.

Barça zyrtarizon transferimin e Braithwaite

Skuadra e Barcelonës e ka zyrtarizuar të enjten transferimin e sulmuesit danez të Leganesit, Martin Braithwaite. Federata e Futbollit të Spanjës i lejoi Barcelonës të transferonte një sulmues brenda 15 ditëve, pasi u konfirmua se Ousmane Dembele nuk do të kthehet këtë stinor shkaku i lëndimit. Kampionia e La Ligës pagoi 18 milionë euro, sa ishte klauzola për lirim e Braithwaites në kontratën me Leganesin. Braithwaite ka firmosur kontratë të vlefshme deri në verën e vitit 2024.

Operohet Federeri, mungon në French Open

Tenisti legjendar Roger Federer ka njoftuar se do të futet në një operacion dhe kësaj do të humbë një mori turnesh. Federer, 38-vjeçar, ka qenë në formë të mirë pavarësisht moshës, por nuk ka marrë aspak lajme të mira pas kontrollit rutinë që pati. Ai do t'i nënshtrohet një operacioni artroskopik në Zvicër dhe do të humbasë turnet e Dubai, Indian Wellsit, Bogotas, Miami dhe atë më të rëndësishmin - French Open. Por lajmi i mirë është se zvicerani do të jetë gati për turneun më të madh në tenis - Wimbledon, i cili mbahet nga muaji qershor.

Shtohen problemet për Juven, lëndohet Higuaini

Janë shtuar telashet për Maurizio Sarrin tri ditë para sfidës ndaj Spalit, pasi sulmuesi Gonzalo Higuain është lënduar në stërvitje dhe rrezikon të mungojë jo vetëm në takimin e radhës në kampionat, por edhe në duelet ndaj Lyonit në Ligën e Kampionëve dhe supersfidën e 1 marsit ndaj Interit. Shpresat janë që argjentinasit të rikuperohen në kohë rekord, por do të jetë e vështirë, ndërkohë me probleme në kampin bardhezi janë edhe dy mesfushorët Pjaniq dhe Rabiot.

Allegri: Nuk kam kontakte me PSG-në

Trajneri Massimiliano Allegri vazhdon të jetë i papunë. Së fundmi tekniku italian ka udhëtuar drejt Parisit dhe kaq ka mjaftuar që të shtohen zërat për një kalim të mundshëm te PSG-ja. Megjithatë, ish-trajneri i Joves e ka mohuar se është në kontakte me skuadrën franceze. "Unë nuk kam asnjë kontakt me PSG-në dhe është mungesë respekti për të tjerët të them që jam në Paris për të folur me Leonardon. Jam këtu për ta paraqitur librin tim dhe përvojat e mia. Në shtator do të kthehem në drejtimin e një skuadre. Studimi në anglisht? Po e mësoj këtë gjuhë për kulturën time personale, pasi kur shkoj jashtë vendit nuk mund të komunikoj në gjuhë tjetër", ka thënë Allegri.



MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO

Republic of Kosovo
Millennium Foundation of Kosovo

Specific Procurement Notice

**Selection of an individual consultant for
PROJECT SUPPORT SPECIALIST - ENERGY EFFICIENCY
IC/ MFK/2020/05**

The Government of Kosovo has received grant funding of UD\$49,000,000.00 (Forty-Nine Million United States Dollars) from the Millennium Challenge Corporation (MCC) of the United States Government to support Kosovo through a Threshold Program which is designed to lower energy costs for households and businesses and to support the Government of Kosovo in its efforts to improve data transparency to spur growth, fight poverty and advance stability. The Millennium Foundation of Kosovo (MFK), the Accountable Entity created by the Government of Kosovo to implement this program and achieve the objectives of the MCC Grant Agreement, intends to apply parts of the proceeds of the funds to payments for Contracts for Goods, Works and Services.

The Project Specialist, Energy efficiency, under the supervision of the Director of Energy, is responsible for the daily execution, monitoring, and supervision of relevant activities and sub-activities supporting the Reliable Energy Landscape Project, with the main focus on the 2 activities: Pilot incentives for household energy efficiency and District Heating Metering to ensure consistency with established work plans and implementation guidelines.

Therefore, MFK is seeking an Individual consultant for

PROJECT SUPPORT SPECIALIST - ENERGY EFFICIENCY.

Applications submission deadline: 05 March 2020, 14:00 pm (Kosovo Time).

Interested eligible consultant may refer to the other relevant documents (LOI/TOR) at:

<https://millenniumkosovo.org/procurement/selection-of-an-individual-consultant-for-project-support-specialist-energy-efficiency-ic-mfk-2020-005/>



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

ATK verifikon mallrat pa origjinë

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë tatimpaguesit se në bazë të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, kërkohet dokumentimi i origjinës së mallit.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi do të përqendrohen pikërisht te tatimpaguesit, të cilët posedojnë mallra pa origjinë.

Secili tatimpagues duhet të ofrojë dokumentacionin mbështetës, i cili arsyeton prejardhjen e mallit si në vendndodhjen, apo vendndodhjet e tatimpaguesit, ashtu edhe për mallrat në qarkullim jashtë vendndodhjes së tatimpaguesit.

Po ashtu, secili tatimpagues duhet të dokumentojë të gjitha mallrat nga koha e pranimit (qoftë përmes importimit, blerjes, shkëmbimit apo mënyrave tjera) deri sa ato të jenë shitur apo ndryshe të jenë sistemuar, përfshirë dokumentacionin e shitjes apo sistemim tjetër.

ATK, inkurajon të gjithë tatimpaguesit që t'i përgjigjen në mënyrë të saktë detyrimeve tatimore, në të kundërtën ATK, do të detyrohet që të ndërmarret masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tuaja tatimore, ju do të kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenies shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

Administrata Tatimore e Kosovës

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se B.N.I "Comerc" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: 70420490 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa B.N.I "Comerc" D.O.O. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : 70420490 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the B.N.I "Comerc" L.L.C. in Prishtina, has come to the decision to quit its business: 70420490 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
Fakulteti Juridik
Studimet e Doktoratës

Në mbështetje të nenit 127 (par. 1) të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" nenit 17 (par. 2 dhe 4) të Rregullores për Studimet e Doktoratës, Vendimit të Këshillit të Fakultetit Juridik, datë 12.07.2019, nr.prot. 02/325 dhe Vendimit për Ratifikim të Senatit të Universitetit të Prishtinës, datë 11.02.2020, nr.prot. 370 kandidatit Ma. Sc. Milot Krasniqi i është lejuar mbrojtja publike e Disertacionit të Doktoratës, andaj nga të cekurat shpallim këtë:

NJOFTIM

Me të cilin njoftojmë të gjithë të interesuarit se me datë 06.03.2020, me fillim nga ora 12:00 në Fakultetin Juridik, në sallën e gjykatore, kandidati Milot Krasniqi, për të fituar titullin "Doktor i Shkencave Juridike nga fusha penale" bën mbrojtjen publike të disertacionit me titull: "Ndërmjetësimi si mënyrë alternative e zgjidhjes së çështjes penale" para komisionit profesional në përbërje prej:

1. Prof. Dr. Rexhep Gashi (Kryetar);
2. Prof. Dr. Haki Demolli (anëtar) dhe
3. Prof. Dr. Altin Shegani (anëtar i jashtëm) nga Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Republika e Shqipërisë.

Prishtinë, datë 21.02.2020

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Kërkoj kujdestare
për vajzën 7 muajshe
në Prishtinë.
Për informata në
tel: 044-444-009**

► Shkumbin Cocaj shpall te pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren

► Gylten Kabashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Matilo Goreci" Prizren

Dafina Gutaj shpall te pavlefshme dëftesat certifikatën shme "Ymer Prizreni" Prizren

► Naser Hoxhaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Dëshmorët e Zhurit" Zhur

► Besart Selimi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Suzana Dragidella shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Xhafa engineering sh.p.k shpall të pavlefshme numrin e rexhistrimit të biznesit: 811395400.

► "Timi Invest" sh.a, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 70624826 dhe numër UNIK: 810800393.

► "Timi Group" sh.a, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër: 71070360 dhe numër UNIK: 810839780.

► "Lux Dentima", SH.P.K. me numër të biznesit 810190249 me adresë në Prishtinë, Rr, Elbasanit p.n i njofton të gjithë debitorët dhe kreditorë se ka marre vendim për zvogëlimin e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet nga shuma fillestare 50000 (pesëdhjetë mijë) në 5000 Euro.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare.

Tel. 044-413-197.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

PASHTETË PULË

gluten
free



cilësi e garantuar

pa konservues